



**RAPORT INFORMIMI**

**AKTIVITETI I INSTITUCIONEVE TË**

**SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E**

**LARTË PËR PERIUDHËN 2016 - 2017**

**Shkurt 2018**

*Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) është person juridik publik. Ajo është përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë. ASCAL, përmes mekanizmave të sigurimit të cilësisë, akreditimit dhe proceseve të tjera, monitoron dhe vlerëson cilësinë e institucionit dhe të programeve të ofruara. ASCAL mbështet veprimtarinë e saj mbi udhëzuesit e saj, standardet në arsimin e lartë dhe standardet dhe udhëzuesit europianë të cilësisë në hapësirën europiane të arsimit të lartë.*

ASCAL

**AGJENCIA PËR SIGURIMIN E CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**  
**QUALITY ASSURANCE AGENCY FOR HIGHER EDUCATION**

*Adresa:*

*Rruga e Durrësit, Pranë Gjinnazit Qemal Stafa, Tiranë*

*Kontakt:*

*Drejtori (Tel/Fax) : 04 2 257954*

*Saktori i Promocionit dhe vlerësimit (Tel/Fax): 04 2 266302*

*Saktori i Statistikave dhe Analizave (Tel/Fax): 04 2 243423*

*Saktori i Shërbimeve dhe Publikimit (Tel/Fax): 04 2 243423*

*E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)*

*Website: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)*



## Shkurtime dhe fjali shpjegues

- **ASCAL – AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**– Institucioni përgjegjës në Republikën e Shqipërisë për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë dhe për akreditimin e institucioneve dhe programeve të studimit në bazë të ligjit nr. 9741,
- **ASCAL - Agjencia e sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë**– Institucioni përgjegjës në Republikën e Shqipërisë për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë dhe për akreditimin e institucioneve dhe programeve të studimit, në bazë të ligjit nr. 80/2015,
- **BA – Bordi i Akreditimit**– Organ kolegjal vendimarrës, i cili akrediton institucionet e arsimit të lartë dhe programet e studimit, krijuar me ligjin nr. 80/2015,
- **MASH/ MASR – Ministria e Arsimit dhe Shkencës / Sportit** – Ministria përgjegjëse për arsimin dhe sportin dhe rininë në Republikën e Shqipërisë
- **MPAL – Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë**
- **IAL – Institucion i arsimit të lartë** – Institucione të arsimit të lartë janë: universitetet, shkollat e larta, kolegjet, akademitë dhe institutet
- **PS – Program studimi** – Programe të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë
- **Vlerësim** – Proces që ndjek ASCAL për të parë përputhshmërinë e një programi në kuadër të licencimit apo akreditimit. Vlerësimi mund të jetë teknik ose në përmbajtje, dhe bëhet me ekspertë të fushës
- **QAA - Quality Assurance Agency**, Agjencia Britanike për Sigurimin e Cilësisë
- **ENQA** – Rrjeti evropian i agjencive për sigurimin e cilësisë (European Network for Quality Assurance)
- **Akreditim** – procedurë vlerësimi e cilësisë në arsimin e lartë, që ndjek ASCAL bazuar në standardet shtetërore dhe ato europiane
- **LAL – Ligji i arsimit të lartë**
- **SSHC – Standardet shtetërore të cilësisë** janë dokumentet themelore që përmbajnë standarde dhe kriteret minimale që duhet të përmbushë çdo institucion dhe program studimi për akreditimin e plotë.
- **SKS – Sondazhi kombëtar i studentëve**
- **ESG – European standards and guidelines** – Udhëzuesit dhe standartet europiane për sigurimin e cilësisë
- **Koordinator i IAL** – Person kontakti i caktuar nga IAL për komunikimin me ASCAL dhe shkëmbim informacioni nëpërmjet sistemit elektronik
- **KT – koordinatori teknik** – Përfaqësuesi i ASCAL që ndjek një proces të caktuar të aplikuar nga një IAL
- **EV**– Ekspert vlerësimi i njohur në një fushë të caktuar i angazhuar nga ASCAL për një proces vlerësimi
- **AMS – ASCAL Management System** - Sistemi i Menaxhimit elektronik i ASCAL
- **GVB – Grupi i vlerësimit të brendshëm** – personat e angazhuar nga IAL për realizimin e një procesi vetëvlerësimi të institucionit apo programit dhe raportit të vetëvlerësimit
- **GVJ – Grupi i vlerësimit të jashtëm** - Përgjegjës për realizimin e procesit të vlerësimit të jashtëm
- **DRVB – Draft raport i vlerësimit të brendshëm** – Raporti paraprak i GVB që i dorëzohet titullarit të IAL për miratim titullarit të IAL ose njësisë kryesore
- **RVB**–Raporti i vlerësimit të brendshëm
- **DRVJ – Draft raport i vlerësimit të jashtëm** – Raporti paraprak i GVJ që i dorëzohet ASCAL
- **RVJ - Raporti i vlerësimit të jashtëm** – Raporti i finalizuar nga GVJ
- **DPA - Dosja e plotë e akreditimit** – Dosja me dokumentacionin e plotë e përgatitur nga ASCAL për shqyrtim në KA (e printuar dhe në sistemin elektronik)
- **VBA – Vendimi i Bordit të Akreditimit** – Vendimi i marrë nga KA pas shqyrtimit të DPA të një procesi akreditimi
- **VKM – Vendim i Këshillit të Ministrave**
- **UMA – Urdhër i Ministrit të Arsimit**

<b>PËRMBLEDHJE E RAPORTIT .....</b>	<b>6</b>
<b>KAPITULLI I.....</b>	<b>7</b>
<b>INSTITUCIONET E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË DHE FUNKSIONIMI I TYRE .....</b>	<b>7</b>
1.1 AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË.....	7
1.2 ORGANIZIMI I ASCAL/BA DHE FUNKSIONET KRYESORE.....	8
1.3 EKSPERTËT E VLERËSIMIT TË JASHTËM .....	10
1.4 BAZA LIGJORE E FUNKSIONIMIT TË ASCAL/BA.....	11
<b>KAPITULLI II .....</b>	<b>12</b>
<b>VEPRIMTARITË KRYESORE TË ASCAL GJATË VITEVE 16-17 .....</b>	<b>12</b>
2.1 PËRGATITJA E DOKUMENTACIONIT NË KUADËR TË RIORGANIZIMIT .....	12
2.2 AKREDITIMI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË ME QAA .....	13
2.2.1 FAZA PËRGATITTORE .....	13
2.2.2 ZHVILLIMI I PROCESIT TË AKREDITIMIT INSTITUCIONAL .....	15
2.2.3 REZULTATET DHE VENDIMARRJA.....	19
2.4. LICENSIMI DHE AKREDITIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT.....	22
2.5. SONDAZHI KOMBËTAR I STUDENTËV, SKS .....	23
<b>KAPITULLI III.....</b>	<b>27</b>
<b>SISTEMI I RUAJTJES DHE ADMINISTRIMIT TË INFORMACIONIT DHE PROCEDURAVE NË ASCAL.....</b>	<b>27</b>
3.1 SISTEMI I MENAXHIMIT TË ASCAL, AMS .....	27
3.2 ADMINISTRIMI I PROCESEVE TË VLERËSIMIT NËPËRMJET AMS DHE MONITORIMI I CILËSISË .....	28
3.3. INFORMIMI DHE PUBLIKIMI I INFORMACIONIT .....	30
3.4.SISTEMI I RUAJTJES, ARKIVIMIT TË INFORMACIONIT DHE I SHËRBIMEVE NË ASCAL	31
<b>KAPITULLI IV.....</b>	<b>33</b>
<b>AKTIVITETE TË TJERA TË ZHVILLUARA NGA ASCAL DHE BA .....</b>	<b>33</b>
4.1 AKTIVITET I BORDIT TË AKREDITIMIT .....	33
4.2. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË OSE TË TJERA NË VEND .....	36
4.3. BASHKËPUNIMI I ASCAL ME RRJETET NDËRKOMBËTARE TË AGJENCIVE TË SIGURIMIT TË CILËSISË .....	36
4.4 AKTIVITETI FINANCIAR I ASCAL DHE BA, 2016 DHE 2017 .....	38
<b>KAPITULLI V .....</b>	<b>47</b>
<b>PLANI I VEPRIMTARIVE PËR VITIN 2018 .....</b>	<b>47</b>

## PËRMBLEDHJE E RAPORTIT

Nga miratimi i ligjit të ri të arsimit të lartë 80/2015, sistemi arsimor në Shqipëri ka kaluar në disa zhvillime e ndryshime të rëndësishme. Fokusi kryesor ka qënë implementimi i këtij ligji në institucionet e arsimit të lartë, riorganizimi i tyre dhe i programeve të studimit në përputhje me këtë ligj.

Pjesë e këtyre zhvillimeve kanë qënë dhe institucionet e sigurimit të cilësisë (Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, ASCAL dhe Bordi i Akreditimit, BA) të cilat jo vetëm janë riorganizuar por kanë zhvilluar mjaft aktivitete në arsimin e lartë, akreditimin dhe sigurimin e cilësisë.

Disa nga drejtimet kryesore të këtyre zhvillimeve kanë qënë:

Riorganizimi i ASCAL dhe BA në përputhje me ligjin e ri të arsimit të lartë, miratimi i akteve rregullatore dhe akteve të brendshme të tyre, vlerësimi i të gjitha institucioneve të arsimit të lartë në bashkëpunim me Agjencinë Britanike të Sigurimit të Cilësisë, QAA, vlerësimi i programeve të studimit në kuadër të licencimit apo akreditimit, përgatitja e infrastrukturës logjistike dhe dokumentacionit të nevojshëm për realizimin e Sondazhit Kombëtar të Studentëve, SKS.

Të gjitha këto zhvillime apo aktivitete të tjera janë paraqitur në këtë raport 2 vjeçar për periudhën 2016 - 2017.

Raporti paraqet në mënyrë të përmbledhur dhe jep informacion të përgjithshëm në lidhje me këto zhvillime por ai është bazuar në referenca dhe materiale të cilat mund të aksesohen nga kushdo që kërkon një informacion më të detajuar.

Çdo e dhënë apo informacion e paraqitur në këtë raport mund të përdoret për qëllime informimi dhe studimi, por në asnjë rast ato nuk mund të keqpërdoren, tjetërsohen apo nxirren jashtë kontekstit për të cilin janë paraqitur.

ASCAL

## KAPITULLI I

# INSTITUCIONET E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË DHE FUNKSIONIMI I TYRE

### 1.1 Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), është person juridik publik përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë. ASCAL, përmes mekanizmave të sigurimit të cilësisë, akreditimit dhe proceseve të tjera, monitoron dhe vlerëson cilësinë e institucionit dhe të programeve të ofruara. ASCAL është krijuar me vendim të KM nr. 303, datë 01.07.1999, [1] “Për krijimin e sistemit të akreditimit në arsimin e lartë” si Agjencia e Akreditimit, riorganizuar në agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë me VKM nr. 424, datë 02.06.2010 “Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë”, [2] i ndryshuar dhe së fundmi riorganizuar në Agjencia e sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 109, datë 15.02.2017, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë” [3].

ASCAL ka si mision kryesor të saj, promovimin dhe sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë bazuar në disa parime themelore si: respektimin e autonomisë institucionale dhe lirisë akademike të institucioneve të arsimit të lartë, transparencën dhe informimin në çdo hap të procesit, mekanizmat e brendshëm të sigurimit të cilësisë në IAL, objektivizmin dhe profesionalizmin në të gjitha proceset e kryera prej saj si dhe në respektimin vetëm të kriterëve dhe standardeve shtetërore të cilësisë, të standardeve evropiane të cilësisë dhe në standardet akademike në AL.

Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri të arsimit të lartë 80/2015 [4] dhe me riorganizimin e saj në vitin 2017, Agjencia ka ndryshuar profil duke u fokusuar më shumë tek promovimi i cilësië duke bashkëpunuar jo vetëm me IAL por edhe me studentët.

Një tjetër institucion, pjesë e sistemit të sigurimit të cilësisë është Bordi i Akreditimit i riorganizuar nga Këshilli i Akreditimit duke fituar më shumë pavarësi dhe kompetenca të reja sikundër është vendimarrja finale për akreditimin e institucioneve apo programeve të studimit. Bordi i Akreditimit është organ kolegjal, që kryen veprimtarinë e tij, pranë ASCAL dhe organizohet sipas përcaktimeve të LAL 80/2015 dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 109, datë 15.02.2017, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë". Bazuar në këtë vendim, numri i anëtarëve të Bordit të Akreditimit është 11.

Bordi i Akreditimit zhvillon aktivitetin e vet pranë ASCAL dhe veprimtaritë kryesore të tij janë të përcaktuara në Vendimin 109 të KM si dhe rregulloren e vet të funksionimit.

## 1.2 Organizimi i ASCAL/BA dhe funksionet kryesore

### *Përbërja, organizimi dhe funksionimi i ASCAL*

Në bazë të vendimit të KM, nr. 424, datë 02.06.2010 "Për miratimin e strukturës së Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë", ASCAL është riorganizuar në tre sektorë dhe numri i punonjësve aktualisht është 15. Struktura organizative përbëhet nga Drejtori i ASCAL, Sektori i Promovimit dhe Vlerësimit të Cilësisë, Sektori i Statistikave dhe Analizave, Sektori i Shërbimeve dhe Publikimit.

Çdo sektor drejtohet nga përgjegjësi i sektorit përkatës. Pjesë e ASCAL janë financa, protokoll, arkiva, rrjeti kompjuterik dhe sistemi i menaxhimit e asete të tjera në funksion të aktivitetit të saj, BA dhe ekspertëve të vlerësimit. ASCAL ofron asistencën teknike për ekspertët e vlerësimit të jashtëm, Bordin e Akreditimit dhe bashkëpunëtorët e saj.

Vendimi Nr. 109 dhe Rregullorja e brendshme e funksionimit të ASCAL, përcakton qartësisht, detyrat dhe funksionet e veçanta për çdo sektor.

#### *a. Sektori i Promovimit dhe Vlerësimit të Cilësisë, SPVC*

SPVC, është i përbërë nga specialistë, të cilët janë të diplomuar në fusha të ndryshme studimi. Fokusi kryesor i këtij sektori është promovimi i cilësisë në IAL dhe monitorimi i procedurave të vlerësimit në kuadër të licencimit dhe akreditimit të programeve/ institucioneve të AL. Vlerësimi i institucioneve /programeve të reja të studimit të arsimit të lartë (publik dhe jo publik) në kuadër të licencimit të tyre (detyrë sipas akteve ligjore deri në Mars 2018), organizimi dhe monitorimi në kohë të procedurave të vlerësimit teknik, përgatitja e materialeve për ekspertët e vlerësimit, vlerësimi me ekspertë të fushës, asistencë teknike ndaj tyre, shqyrtimi i aplikimeve në kuadër të akreditimit institucional ose të programeve të studimit, monitorimi i gjithë procesit të akreditimit, komunikimi me IAL dhe bashkërendimi i aktiviteteve në kuadër të akreditimit, menaxhimi i proceseve dhe procedurave nëpërmjet sistemit të menaxhimit të ASCAL, përgatitja e materialeve, trajnime dhe shërbime në funksion të ekspertëve, administrimin e plotë të dokumentacionit të akreditimit dhe përgatitjen e dosjeve për shqyrtim në Bordin e Akreditimit. Një nga detyrat më të rëndësishme të këtij sektori është dhe koordinimi i punës së BA dhe ekspertëve, duke vënë në funksion të tyre të gjithë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm, materiale, raporte etj. Gjithashtu detyrë e rëndësishme është trainimi dhe kualifikimi i anëtarëve të sektorit nëpërmjet pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare etj. Takimet me përfaqësuesit e IAL me qëllim mirëfunksionimin e strukturave të sigurimit të cilësisë në IAL, janë një tjetër fokus i SPVC për promovimin e cilësisë.

Po ashtu, ky sektor është pjesë e pandarë e aktiviteteve të tjera që zhvillon ASCAL, BA apo Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në fushën e arsimit të lartë dhe sigurimit të cilësisë.

#### *b. Sektori i Statistikave dhe Analizave, SSA*



SSA, është strukturë e krijuar në vitin 2010, me miratimin e rregullore së re të sistemit të akreditimit dhe sigurimit të cilësisë. Ky sektor ka një rol të veçantë dhe mjaft të rëndësishëm në strukturën e ASCAL dhe sistemin e arsimit të lartë në tërësi. Detyrat themelore të këtij sektori janë menaxhimi i informacionit elektronik dhe të dhënave në arsimin e lartë, analiza cilësore, sasiore e krahasuese në arsimin e lartë për institucionet, programet apo aspekte të veçanta të tyre si stafet akademike, kërkimi shkencor, facilitetet etj.

Një nga detyrat më të rëndësishme përcaktuar në LAL 80/2015 dhe VKM për ASCAL është vlerësimi i mësimdhënies nëpërmjet sondazhit Kombëtar të Studentëve. Ky angazhim i ri i ASCAL do të jetë një nga detyrat primare në të ardhme e cila do të realizohet kryesisht nga SSA.

Fokus tjetër i SSA është mbledhja e të dhënave për të gjitha institucionet e arsimit të lartë, menaxhimi i sistemit elektronik të komunikimit midis ASCAL, BA, ekspertëve dhe institucioneve për unifikimin e proceseve dhe procedurave të vlerësimit dhe akreditimit, informimin, rritjes së transparencës etj.,. Një rol të rëndësishëm në aktivitetin e këtij sektori zë përgatitja e materialeve, raporteve dhe të dhënave për ekspertët, BA, për publikim dhe informim. Stafi i këtij sektori angazhohet gjithashtu në të gjitha aktivitetet dhe proceset që ASCAL zhvillon në fushën e arsimit të lartë.

#### *c. Sektori i Shërbimeve dhe Publikimit, SSHP*

Pjesë e këtij sektori janë financa, publikimi, protokoll/arshiva dhe asetet e ASCAL.

Aktiviteti i tij kryesor është fokusuar në mbështetjen financiare dhe logjistike të ASCAL, BA dhe ekspertëve vendas dhe të huaj. Po ashtu menaxhimi i dokumentacionit elektronik nëpërmjet AMS është po ashtu një funksion mjaft i rëndësishëm i këtij sektori. Në funksion të mirëfunksionimit të ASCAL, SSHP menaxhon sistemin e prokurimit dhe investimeve në ASCAL. Ky sektor kryen gjithashtu publikimin e materialeve dhe botimeve të ASCAL/BA në kuadër të informimit të publikut. Gjithashtu, mbështetja për organizimin e aktiviteteve trajnuese dhe promovuese të cilësisë në Arsimin e Lartë, në bashkëpunim me të gjithë faktorët e interesuar, është një nga detyrat e rëndësishme të këtij sektori.

#### ***Përbërja dhe organizimi i Bordit të Akreditimit***

Bordi i Akreditimit është riorganizuar në vitin 2017. BA është i përbërë nga 11 anëtarë nga të cilët minimalisht 3 dhe maksimalisht 5 duhet të jenë të huaj. Të gjithë anëtarët janë personalitete të botës akademike me një eksperiencë të gjatë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor brenda dhe jashtë territorit të RSH.

Anëtarët dhe kryetari i Bordit emërohen dhe shkarkohen nga kryeministri me propozimin e ministrit përgjegjës për arsimin. Mandati i anëtarëve të BA është 4 vjet. Bordi i Akreditimit u emërua me urdhër të Kryeministrit nr. 32, datë 17.03.2017 dhe organizoi mbledhjen e tij të parë në datën 07.04.2017 [5].

BA është vazhdues i punës së Këshillit të Akreditimit i krijuar në bazë të ligjit të arsimit të lartë nr. 9741, datë 21.05.2007. Ligji i ri i arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, nr. 80/2015, i jep fuqinë BA për të marr vendimin përfundimtar mbi akreditimin e institucioneve të arsimit

të lartë dhe programve që ato ofrojnë. Në funksionet e veta, BA bashkëpunon me të gjitha institucionet që operojnë në fushën e arsimit të lartë, politikëbërjes dhe vendimarrjes duke dhënë rast pas rasti rekomandime për sigurimin e cilësisë në fushën e arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor. I gjithë aktiviteti i BA, përfshirë edhe ai financiar, sigurohet dhe drejtohet nga stafi i ASCAL.

Anëtarët e BA mund të jenë pjesë e grupeve/komisioneve të ngritura për çështje të caktuara. Në rastet kur këto tematika nuk mbulohen nga ekspertiza e anëtarëve të Bordit apo edhe kur gjykohet e nevojshme, Bordi mund të kërkojë edhe ekspertë ose konsulentë të jashtëm që ta asistojnë për formulimin e vendimeve. Bordi mbledhet jo më shumë se 9 (nëntë) herë në vit. Anëtari i BA-së, që mungon në 1/3 e mbledhjeve, zëvendësohet.

### **1.3 Ekspertët e vlerësimit të jashtëm**

Në ushtrimin e veprimtarisë së saj të vlerësimit dhe akreditimit, ASCAL dhe Bordi i Akreditimit aktivizojnë dhe bashkëpunojnë me ekspertë të jashtëm të vlerësimit dhe/apo konsulentë. Një arritje e rëndësishme në kuadër të akreditimit të institucioneve dhe programeve të studimit, është përfshirja e ekspertëve të huaj edhe në akreditimin e programeve të ciklit të dytë.

ASCAL dhe BA përditësojnë bazën e të dhënave të ekspertëve të vlerësimit dhe të konsulentëve, vendas apo të huaj ku prioritet janë kualifikimet e duhura për llojin e vlerësimit që kryejnë, si dhe pavarësia për të dhënë një gjykim të drejtë dhe pa ndikime, duke shmangur çdo konflikt të mundshëm interesi. Kriteria të tjera për ekspertët e vlerësimit janë; të jenë figura të njohura në fushën përkatëse të shkencës, të kenë përvojë prej të paktën 5 (pesë) vjetësh në mësimdhënie dhe në kërkim shkencor, të kenë të paktën gradën shkencore “Doktor”, të kenë përvojë në sigurimin e cilësisë në institucionet e arsimit të lartë, të kenë integritet të lartë personal dhe profesional, të kenë përvojë ndërkombëtare, të fituar përmes studimeve pasuniversitare, apo kualifikim shkencor në universitete a qendra kërkimore perëndimore. Gjithashtu, çdo ekspert duhet të nënshkruajë një deklaratë, ku garanton për pavarësinë në veprimtarinë e tij dhe mungesën e konfliktit të interesit, të trajtojnë të gjitha materialet dhe rezultatet e vlerësimit si krejtësisht konfidenciale. Pas pranimit si ekspertët e vlerësimit, ata regjistrohen në sistemin e menaxhimit, pajisen me kredencialet përkatëse dhe me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor dhe cilësor të institucioneve për vlerësimin e të cilëve përzgjidhen. Për të gjithë procedurën, veprimtaria me dosjen e vetëvlerësimit dhe vizitat në vend, vlerësuesi harton raportin e vlerësimit të jashtëm të cilësisë, të cilin e dorëzon për procedura të mëtejshme në Agjencinë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë. Aktualisht ASCAL ka një databazë prej 350 ekspertësh vendas dhe të huaj të fushave të ndryshme të cilët angazhohen rast pas rasti. Pas çdo angazhimi ekspertët i nënshtrohen një vlerësimi nga Menaxheri i Vlerësimit dhe ky vlerësim bëhet pjesë e dosjes së tij. Ekspertët mund të angazhohen nga ASCAL dhe BA për t'i ndihmuar me mendime dhe propozime për kriteret dhe metodat e vlerësimit, për rrugët dhe format e rritjes së cilësisë në arsimin e lartë, si dhe hartimin e dokumenteve që ndihmojnë procesin në tërësi.

## 1.4 Baza ligjore e funksionimit të ASCAL/BA

Në Shqipëri, Sistemi i Akreditimit ka një eksperiencë disa vjeçare. ASCAL dhe BA, e bazojnë aktivitetin e vet në një sërë dokumentësh ligjore si: Ligje, Vendime të Këshillit të Ministrave, Udhëzime të Ministrisë Përgjegjëse për Arsimin e Lartë, Manuale dhe Procedura të hartuara nga ASCAL dhe të miratuara nga BA, Kodin e Cilësisë etj.

Disa nga dokumentet ligjore të funksionimit të ASCAL/BA janë:

- Ligji Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 *“Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”*
- Standardet shtetërore të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë (miratuar me Urdhëra të Ministrisë përgjegjëse (2011/2013). Këto standarde përcaktojnë kriteret që duhet të plotësojnë institucionet e arsimit të lartë për hapjen/ licencimin e programeve të reja apo për akreditimin.
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 109, datë 15.02.2017, *“Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë”*.
- Udhëzimet e Ministrisë Përgjegjëse për Arsimin e Lartë, të cilat koordinojnë mjaft nga procedurat e ASCAL, jo vetëm në kuadrin e vlerësimit por edhe për marrëdhëniet institucionale të ASCAL me institucionet e tjera dhe marrëdhëniet financiare të ASCAL me institucionet e arsimit të lartë dhe ekspertët.
- *“Standards and Guidelines for Quality Assurance in the European Higher Education Area”* (Standardet dhe udhëzimet të cilësisë në hapësirën europiane të arsimit të lartë dhe atë ndërkombëtare të arsimit të lartë, ndryshuar në vitin 2015). Këto standarde janë reflektuar në dokumentet bazë të funksionimit të ASCAL si procedura të vlerësimit/akreditimit etj.
- *“Rregulloren e Sistemit të Akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë”*, e ndryshuar etj.
- Manuali për procedurat e akreditimit të institucioneve dhe të programeve të studimit, miratuar në vitin 2015 dhe rishikuar në vitin 2017 si dhe aspekte dhe procedura të miratuara nga BA

## KAPITULLI II

### VEPRIMTARITË KRYESORE TË ASCAL GJATË VITEVE

2016-2017

#### 2.1 Përgatitja e dokumentacionit në kuadër të riorganizimit

ASCAL në kuadër të riorganizimit në përputhje me ligjin e ri të arsimit të lartë ka dhënë vazhdimisht kontribut në përmirësimin e mëtejshëm të bazës ligjore që lidhet me arsimin e lartë dhe sigurimin e cilësisë. Në zbatim të ligjit 80/2015, ASCAL dhe BA aktualisht kanë përfunduar ose kanë në përfundim disa akte rregullative të funksionimit të brendshëm të dy institucioneve sikundër janë Rregulloret e brendshme të ASCAL dhe BA të cilat reflektojnë një sërë ndryshimesh dhe atributesh që dalin nga ligji i arsimit të lartë.

Stafi i ASCAL vazhdimisht propozon dhe jep mendime gjatë hartimit të akteve nënligjore. Angazhimi kryesor i stafit të ASCAL ka qënë pjesmarrja në grupet e punës të ngritura për hartimin dhe diskutimin e ligjit të ri të arsimit të lartë. Po ashtu, titullari i ASCAL Bordit të Akreditimit kanë qënë pjesë e Komisionit të Reformës në Arsimin e Lartë dhe pjesë e grupeve të punës për diskutimin e tij me palët e interesuara.

ASCAL ka rishikuar procedurat e veta të vlerësimit dhe akreditimit të institucioneve dhe programeve të studimit: “*Manuali për procedurën dhe afatet për vlerësimin e cilësisë për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe të programeve të studimit*”, i miratuar në qershor 2015. Ky manual që përcakton qartësisht hapat, procedurat, afatet kohore dhe përgjegjësitë e të gjithë faktorëve pjesmarrës në një proces akreditimi institucional apo programesh studimi, është miratuar nga Bordi i Akreditimit në vitin 2017 [6], [7].

Disa nga aktet kryesore të brendshme që organizojnë punën e ASCAL/ BA, janë rishikuar ose hartuar nga e para:

- Rregulloret e brendshme të funksionimit të ASCAL dhe BA
- Manuali/procedura për proceset e akreditimit institucional dhe të programeve të studimit
- Manuali i vlerësimit të institucioneve të arsimit të lartë (në bashkëpunim me QAA)
- Formate/modele për kalendarin e aktiviteteve të akreditimit, model vendimi për akreditimin final etj.

Ndërkohë disa grupe pune të ngritura nga Bordi i Akreditimit, kanë përfunduar ose janë në përfundim të disa dokumenteve themelore të përcaktuar në ligjin 80/2015

- Janë në përfundim standardet për sigurimin e cilësisë dhe vlerësimin institucional për institucionet e arsimit të lartë. Këto standartë para se të miratohen dhe të bëhen pjesë e kodit të cilësisë, janë diskutuar me institucionet e arsimit të lartë dhe ekspertët e vlerësimit
- Janë në proces, standardet për sigurimin e cilësisë dhe vlerësimin e programeve të studimit për të tre ciklet e studimit si dhe për programet profesionale.
- Është hartuar dhe miratuar nga Bordi i Akreditimit, Manuali për zhvillimin e Sondazhit Kombëtar të studentëve i cili shpjegon në detaje metodologjinë që do të ndiqet për realizimin e SKS

- Është finalizuar grupi i pyetjeve që do të jenë pjesë e SKS

## 2.2 Akreditimi i Institucioneve të Arsimit të Lartë me QAA

### 2.2.1 Faza përgatitore

Një nga proceset më të rëndësishme i zhvilluar gjatë periudhës 2016 – 2017 është akreditimi i të gjitha institucioneve të arsimit të lartë në republikën e Shqipërisë, proces i cili u nis nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe i zhvilluar nga Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe Agjencia Britanike për Sigurimin e Cilësisë. Prosesi ka angazhuar disa institucione njëkohësisht dhe është finalizuar me një analizë përfundimtare të procesit dhe me raportin përfundimtar të realizimit të tij të hartuar nga të dy agjencitë e përfshira në proces. Detajet janë dhënë në Raportin përmbljedhës mbi ecurinë e procesit të vlerësimit dhe akreditimit institucional të Institucioneve të Arsimit të Lartë në bashkëpunim me Agjencinë Britanike të Sigurimit të Cilësisë QAA-UK

Procesi i Vlerësimit të Jashtëm të Cilësisë dhe akreditimit institucional të IAL-ve në Shqipëri u zhvillua në zbatim të Kontratës së lidhur në 29.02.2016 midis Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (sot MASR) dhe Agjencisë Britanike të Sigurimit të Cilësisë QAA\_UK. Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (sot ASCAL) është autorizuar nga MAS të ndjekë zbatimin e kontratës në përputhje me parashikimet dhe afatet kohore të saj.

Në këtë proces u përfshirë 35 IAL, të ndarë në 7 grupe. Në grupet e para (1,2 3 dhe 4) janë përfshirë institucionet që nuk i ishin nënshtruar asnjëherë procesit të vlerësimit të jashtëm dhe akreditimit (institucionet publike të arsimit të lartë) dhe IAL jopublike që ishin në afatin e akreditimit të parë ose të riakreditimit. Grupet 5, 6 dhe 7 përbëhen kryesisht nga IAL jopublike të cilat ishin pranë afatit për akreditim të parë, riakreditim si dhe IAL që kishin një akreditim të vlefshëm 9 (grupi 7) por u përfshinë në proces.

I gjithë procesi u zhvillua në disa faza të rëndësishme në përputhje me kontratën e nënshkruar:  
Faza përgatitore: Mars – Maj 2016


- Përgatitja e Metodologjisë dhe Manualit të posaçëm QAA-APAAL
- Kriteret e përzgjedhjes së ekspertëve të vlerësimit
- Përzgjedhja e ekspertëve të vlerësimit;
  - 25 ekspertë të përzgjedhur nga QAA\_UK
  - 14 ekspertë shqiptarë të përzgjedhur nga Këshilli i Akreditimit (Bordi i Akreditimit).
- Trajnimi i ekspertëve britanikë dhe shqiptarë.

1. Përgatitja e Metodologjisë dhe Manualit të Vlerësimit; në këtë fazë dymujore (mars-prill 2016) QAA-UK dhe APAAL punuan së bashku dhe përgatitën Manualin e posaçëm “Vlerësimi Institucional i IAL-ve në Shqipëri 2016-2017). Ky material u diskutua gjerësisht me IAL-të përmes disa takimeve të hapura me IAL-të, me titullarët e tyre dhe përfaqësuesit teknikë të IAL-ve.


2. Përzgjedhja e ekspertëve të vlerësimit; në këtë proces janë përfshirë 25 ekspertë të përzgjedhur nga QAA\_UK dhe 13 ekspertë shqiptarë të përzgjedhur nga Këshilli i Akreditimit (sot Bordi i Akreditimit). Grupet e vlerësimit të jashtëm, në varësi të madhësisë së IAL, përbëheshin nga 6, 4 ose 3 ekspertë gjithsej, me shumicë britanike dhe ku kryetari i grupit në të gjitha rastet ishte ekspert i QAA. Ekspertët britanikë u trajnuan paraprakisht në Gloucester nga QAA në prani të përfaqësuesve të APAAL, ndërsa ata shqiptarë në Tiranë nga ekspertë të QAA.

Faza e Vlerësimit të institucioneve 1 qershor 2017- 12 tetor 2017

- 35 IAL në 7 grupe vlerësimi
- Grupi 1- 6 IAL: 1 qershor-22 dhjetor 2016
- Vlerësimi i fazës së parë nga APAAL-QAA, IAL dhe ekspertët;
- Vlerësimi Grupet 2-7 – 29 IAL: 1 janar-12 tetor 2017



## Strukturat akademike të vlerësuara



Aspekti më rëndësishëm qëndron në faktin se ishte procesi i parë për institucionet publike të arsimit të lartë si dhe të gjitha institucionet u vlerësuan njëkohësisht me të njëjtin proces dhe metodologji.

### 2.2.2 Zhvillimi i procesit të akreditimit institucional

Procesi i akreditimit kaloi në disa hapa të rëndësishme sikundër ishte: analiza e bazës ligjore që do të ndiqej, adaptimi i standarteve, përgatitja e manualit të vlerësimit, procedura që do të ndiqej bazuar në metodologjinë e vlerësimit të QAA dhe APAAL si dhe në ESG, Standardet Shtetërore të Cilësisë të përkthyer, riorganizuar dhe përshtatur enkas për këtë proces sipas 5 fushave të vlerësimit, ekspertizë ndërkombëtare me ekspertët më të njohur britanikë dhe shqiptarë, metodologjia e gjykimit dhe vendimmarrjes e cila lehtësoi së tepërmi procesin e analizës dhe vendimmarrjes finale.

Procesi i akreditimit institucional tërësisht bazohej në vlerësim me ekspertizë ndërkombëtare & përkundrejt udhëzimeve europiane. Një nga sfidat më të mëdha ka qënë përgatitja e procesit dhe menaxhimi i tij tërësisht në gjuhën angleze dhe i menaxhuar plotësisht on line.

Nga shqyrtimi dhe analizës paraprake të standardeve shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin institucional, në fuqi që në vitin 2011, nga ekspertët e QAA, rezultoi që këto standarde ishin jo mirëorganizuar, fragmentare dhe me përsëritje, orientuar dhe nga standardet europiane të cilësisë së ENQA 2015. Për këtë arsye ato u riorganizuan/rigrupuan sipas 5 fushave kryesore: Organizimi dhe menaxhimi, Burimet, Kurrikula, Mësimdhënia, Mësimnxenia, Vlerësimi dhe Kërkimi, Studentët. Në secilën prej tyre u përfshinë kriteret respektive.


Një rëndësi e veçantë iu kushtua fazës paraprake të përgatitjes së institucioneve dhe ekspertëve të vlerësimit. Në këtë kuadër, në bashkëpunim me QAA janë organizuar disa trajnime, seminare

etj, fillimisht me ekspertë britanikë e mandej me ekspertët shqiptarë, ku rëndësia kryesore ishte shpjegimi i metodologjisë së vlerësimit, standartet e rigrupuara dhe baza ligjore e operimit dhe funksionimit të institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri. Për çdo institucion, janë realizuar takime të vazhdueshme para fillimit të procesit, me titullarët, njësitë e vlerësimit të brendshëm, grupet e punës. Ndërkohë kontakti me IAL ka qënë i vazhdueshëm nëpërmjet koordinatorit institucionial.

Procesi i vlerësimit u krye në 12 faza kryesore nëpërmjet një procedure të menaxhuar on line nga Sistemi i Menaxhimit të ASCAL që ka rezultuar shumë efektiv e eficient për këtë proces madhor e ku komunikimi me IAL-të për dokumentacionin e komunikimin teknik nuk do arrihej as në vëllim dhe as në cilësi, përmes formave tradicionale burokratike shkresore.

Dy nga fazat më të rëndësishme të procesit ishin vetëvlerësimi dhe vlerësimi i jashtëm.

Vetëvlerësimi bazohet në përgatitjen e informacioneve dhe paraqitjen e të dhënave institucionale, hartimin e raportit të vetëvlerësimit dhe të dokumentacionit mbështetës/verifikues të vlerësimit. Në këtë kuadër institucionet kanë paraqitur një dokumentacion voluminoz në dy gjuhë, shqip dhe anglisht. Nga reagimi i mëpasshëm i IAL-ve rezulton se ky proces ka nxitur dhe ndihmuar IAL-të të grumbullojnë, organizojnë dhe sistemojnë dokumentacionin ekzistues në shërbim të një procesi të shëndetshëm për ta, por që mbetet e do japë efekte afatgjatë në menaxhimin e përmirësimin e brendshëm të cilësisë. Kjo është vecanërisht e vlefshme për IAL publike, të cilat nuk i ishin nënshtruar asnjëherë një procesi cilësie, pavarësisht detyrimit ligjor që nga ligji i vitit 2007.



Në dokumentacionin e vetëvlerësimiti përfshiheshin Raporti dhe dokumentacioni mbështetës, të dhëna të përgjithshme institucionale, Profili institucional, Rezultatet e pyetësorëve të stafit, Rezultatet e pyetësorëve të studentëve, ku në total janë administruar dhe menaxhuar:

35 RVB dhe 6669 dokumente: shqip dhe anglisht, 80% në gjuhën angleze me diversitet dokumentacioni nga institucione të ndryshme nga 50 në 350 dokumente.





Po ashtu gjatë kësaj faze, ASCAL organizoi pyetësorët e safeve akademike dhe studentëve ku:

4,361 pyetësorë për stafin akademik të shpërndara në të gjitha IAL, 2,354, 54% janë përgjigjur, nivele të ndryshme pjesëmarrjeje midis 10% - 90% për institucione të ndryshme dhe 35 raporte të rezultateve në gjuhën angleze për grupet e vlerësimit dhe IAL,

dhe sondazhi më i madh i kryer ndonjëherë në vendin tonë në fushën e arsimit të lartë me

90,440 pyetësorë për studentët në të gjitha IAL ose 70% e të gjithë studentëve, 21,000 prej tyre, 24% janë përgjigjur pyetësorit, ka patur pjesmarrje e lartë në disa IAL private dhe disa publike dhe në disa publike nën 10% , ndërkohë u përgatitën 35 raporte analitike me rezultatet e pyetësorit në dispozicion të vlerësimit dhe IAL.




Vlerësimi i jashtëm është bazuar në analizë, vlerësimin e dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe vlerësimin përmes vizitës në institucion. Grupet e vlerësimit të jashtëm kanë vlerësuar dhe dakordësuar vlerësimin dhe gjykimet pjesore e tërësore për të gjitha IAL\_të në mënyrë kolegjale. Vlerësimi mbi bazë dokumentacioni, është pasuar me vizitën në Institucion

dhe draftimin e raportit përfundimtar bazuar në të dy komponentët e vlerësimit. Pjesë e këtij vlerësimi u bënë dhe rezultatet e pyetësorëve të stafit dhe studentëve, të organizuar, mbledhur e përpunuar nga APAAL. Edhe pse këta të fundit, nuk determinuan vendimmarrjen, kjo përbën një përvojë të parë për ASCAL-in sot, për detyrimin e ri në kuadër të ligjit 80/2015 për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies përmes Sondazhit Kombëtar të Studentëve.

Grupet e vlerësimit kanë qëndruar në IAL-të përkatëse 2 deri në 3 ditë në varësi të madhësisë së IAL. Ata kanë kryer takime sipas axhendave të paracaktuara e parainformuara Institucioneve. IAL-të kanë qenë shumë bashkëpunuese në këtë proces si me ekspertët e vlerësimit ashtu dhe APAAL në menaxhimin e realizimin me përpikmëri të axhendave të takimeve.

Në përfundim të kësaj faze, grupet e vlerësimit të jashtëm kanë hartuar draft-raportet e vlerësimit, të cilat u janë dërguar më pas institucioneve përkatëse për komente apo sqarime.

Procesi i vlerësimit përmbyllet me hartimin e raportit përfundimtar të ekspertëve, të edituar dhe korrigjuar nga QAA\_UK. Raporti i vlerësimit, përvec pjesës së vlerësimit përkundrejt standardeve, përcakton “gjetjet” e vlerësimit; në këto të fundit përfshihen pikat e dobëta, pohime (afirmime të masave të mara nga IAL në kuadër të problematikave dhe cilësisë), praktikat e mira dhe rekomandimet përkatëse. Mbështetur në rezultatet e vlerësimit përkundrejt standardeve, ekspertët kanë dhënë gjykimet e tyre në lidhje me fushat e vecanta dhe vlerësimin tërësor, sipas kategorive: i përmbush plotësisht standardet, i përmbush kryesisht (në pjesën më të madhe), i përmbush pjesërisht ose nuk i përmbush standardet.



Pas përfundimit të vizitës në institucion, grupet e vlerësimit kanë hartuar raportet e vlerësimit të jashtëm ku në çdo rast ekspertët vlerësonin shkallën e përmbushjes së Standardeve të Cilësisë sipas fushave të vlerësimit institucional


- Nuk përmbushen
- Përmbushen pjesërisht



- Përbushen kryesisht
- Përbushen plotësisht

### 2.2.3 Rezultatet dhe vendimarrja


Vendimarrja përfundimtare për akreditimin e institucionit dhe kohëzgjatjen e akreditimit është kompetencë e Bordi të Akreditimit. Vendimarrja e BA mund të jetë akreditohet ose nuk akreditohet. Në rastet e akreditimit pozitiv, kohëzgjatja e akreditimit bëhet sipas cilësisë së gjetur në institucion, mbështetur në gjykimet e Vlerësimit të jashtëm, sipas fushave të vlerësimit dhe ai përfundimtar.

Në përfundim të procesit 35 IAL morën Akreditim Pozitiv ose 100 % e institucioneve që morën pjesë në proces, kohëzgjatje të akreditimit nga 1 në 6 vite, mesatarja e kohëzgjatjes së akreditimit për të gjitha IAL 3.9 vite ndërsa mesatarja e kohëzgjatjes së akreditimit në IAL-të Publike 3.3 vite dhe mesatarja e kohëzgjatjes së akreditimit në IAL-të Jopublike 4.2 vite.





Një nga aspektet më të rëndësishme të procesit ka qenë evidentimi i problematikave nëpërmjet gjetjeve dhe konstatimeve. Në tërësi janë evidentuar rreth 150 praktika të mira, 135 dobësi, rreth 140 rekomandime si dhe rreth 60 afirmime. Rekomandimet e dhëna për institucionet kanë qenë të llojeve të ndryshme dhe të fokusuar në të 5 fushat e vlerësimit. Evidentimi i mangësive dhe përmbushja e rekomandimeve të lëna është tashmë një sfidë për IAL në kuadër të përmirësimit të mëtejshëm të cilësisë në arsimin e lartë. Çdo institucion ka hartuar planin e veprimit të cilin e ka dërguar në ASCAL duke shpjeguar përmbushjen e rekomandimit dhe kohëzgjatjen. Agjencia për çdo institucion ka hartuar një procedurë të posaçme monitorimi e cila do të ndiqet për plotësimin e rekomandimeve të lëna.



*Bashkëpunimi dhe vlerësimi me/nga aktorët e procesit*

Të gjithë aktorët dhe faktorët e angazhuar në procesin e vlerësimit (MASR, APAAL – QAA\_UK, APAAL-IAL, APAAL-QAA-Grupet e Vlerësimit, BA) kanë patur një bashkëpunim të frytshëm dhe në kohë reale. Në përfundim të vlerësimit të grupit të parë dhe në përfundim të të gjithë procesit, është marrë mendimi i të gjithë aktorëve nëpërmjet disa pyetësorëve të shpërndarë për institucionet, ekspertët, drejtuesit e grupeve si dhe mendimi i agjencive respektive. Institucionet kanë qenë bashkëpunuese dhe konstruktive në këtë proces dhe mbështetja e APAAL ka qenë e plotë dhe e vlerësuar pozitivisht nga QAA dhe IAL-të. Shtojmë se reagimi i 29 IAL-ve që kanë sjellë komentet e tyre pas marrjes së draft-raportit shprehen me nota maksimale vlerësimi për procesin, për vlerën që ky proces ka për to, për seriozitetin, nivelin e ekspertizës dhe të menaxhimit e koordinimit të tij.

Në përfundim, i gjithë ky proces solli disa përfitime që lidhen në tërësi për Sistemin e Arsimit të Lartë, Politikëbërësit dhe Vendimmarrësit, institucionet e arsimit të lartë, ngritjen e kapaciteteve të ASCAL dhe ndërkombëtarizimi i proceseve të vlerësimit, përshtatja e procedurave dhe funksionimit të vlerësimit e akreditimit në përputhje me standardet ndërkombëtare.

I gjithë procesii vlerësimit dhe raportet e akreditimit janë bërë publike në faqen e internetit te ASCAL.

## 2.4. Licencimi dhe akreditimi i programeve të studimit

Bazuar në ligjin 80/2015, vlerësimi në kuadër të licensimit të programeve të reja të studimit, është kompetencë e ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë. Për faktin se vitet 2016 dhe 2017, përkojnë me periudhën tranzitore të implementimit të ligjit të ri, si dhe deri në konsolidimin e njësive përgjegjëse për këtë proces në MASR, agjencia është angazhuar edhe për realizimin e këtij procesi. Edhe pse vlerësimet në kuadër të licensimit kanë rënë mjaft krahasuar me vitet e tjera, ASCAL në vitin 2016 ka kryer 23 procese vlerësimi në kuadër të licensimit, nga të cilat 9 janë për hapjen e programeve të studimit në IAL publike dhe 14 për hapjen e programeve në IAL private, dhe në vitin 2017 janë kryer nga ASCAL 16 procese vlerësimi në kuadër të licensimit, 14 nga IAL private dhe 2 nga IAL publike.

Ndërkohë që vendimarrja është e Ministrit përgjegjës për arsimin e lartë, Bordi i Akreditimit (Këshilli i Akreditimit, viti 2016) ka përcjellë vendimet përkatëse në formën e rekomandimit për hapjen ose jo të këtyre programeve.

Nga më sipër, nga 114 programe të vlerësuara, 109 janë vlersuar pozitivisht dhe 5 negativisht duke rekomanduar rast pas rasti hapjen ose jo të këtyre programeve.

Lidhur me akreditimin e programeve të studimit, ky proces ka ecur normalisht pavarësisht angazhimit të ASCAL me akreditimin e institucioneve. Vlen të theksohet se edhe gjatë kësaj periudhe, ASCAL ka kryer procese akreditimi ose riakreditimi të programeve në institucionet jo publike të arsimit të lartë.

Në total janë zhvilluar 79 procedura akreditimi në vitin 2016 dhe 73 në vitin 2017.

Meqënëse procesi i vlerësimit zgjat në kohë, ka procedura të tjera vlerësimi që janë në proces zhvillimi dhe do të përfundojnë gjatë vitit 2018.

## 2.5. Sondazhi Kombëtar i Studentëve, SKS

Bazuar në ligjin nr. 80/15, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe VKM nr. 109, datë 15.02.2017, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë", një nga mekanizmat kryesorë të sigurimit të jashtëm të cilësisë është vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet Sondazhit Kombëtar të Studentëve (SKS). Kjo metodologji është e përhapur në mjaft vende me arsim të lartë të konsoliduar dhe përdoret jo vetëm për këtë qëllim, por për të nxjerrë informacione të nevojshme për funksionimin e arsimit të lartë në tërësi apo aspekte të veçanta të operimit dhe funksionimi. Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet nëpërmjet vlerësimit në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe të programeve të studimit, proces i cili finalizohet me vendimarrjen përfundimtare të akreditimit nga Bordi i Akreditimit. Pas akreditimit të parë ose periodik, është e nevojshme garantimi i standarteve të cilësisë në IAL nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm të zbatimit të tyre nga institucionet e arsimit të lartë. SKS në asnjë rast nuk do të zvëndësojë apo mbivendoset me procesin e akreditimit por ka si qëllim kryesor mbledhjen e informacioneve të nevojshme nga janë studentët.

Nëpërmjet SKS, ASCAL, BA do të vlerësojnë se në çfarë mase institucionet zbatojnë standardet e cilësisë, parë me syrin e studentëve. Procesi do të kryhet në mënyrë periodike çdo tre vjet por mund të zhvillohet edhe në periudha ndërmjetëse për vlerësime specifike kur kërkohet nga Bordi i Akreditimit ose ministri apërgjegjëse për arsimin e lartë në kuadër të analizave kombëtare në arsimin e lartë, për politikëbërjen etj. Procesi është anonim dhe bazohet tërësisht në opinionin individual të studentëve për institucionet përkatëse ku ata studiojnë. Në asnjë rast, mendimet, përgjigjet, opinionet apo informacionet e dhëna individualisht, nuk do të jenë objekt i diskutimit, analizës dhe refencës rast pas rasti. Të dhënat dhe informacionet e marra do të përpunohen statistikisht me anën e programeve kompjuterike dhe do të përdoren në mënyrë të tillë për qëllimet e sipërcituara pa referenca individuale.

Në përfundim të procesit hartohet Raporti analitik me rezultatet e pyetësorëve për çdo IAL shoqëruar me analizat përkatëse si dhe analiza krahasuese për indikatorë të ndryshme përkundjet interesit publik apo të politikëbërjes. Ky raport bëhet publik dhe i vihet në dispozicion Bordit të Akreditimit dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë në kuadër të vendimarrjes dhe politikëbërjes. Realizimi i SKS është detyrim ligjor në kuadër të sigurimit të cilësisë dhe për këtë arsye këtij procesi do t'i nënshtrohen të gjitha IAL që operojnë në Republikën e Shqipërisë apo filiale të institucioneve të huaja të licensuara në vendin tonë.

Ky manual i përgatitur nga ASCAL dhe BA dhe miratuar nga BA, është pjesë e "Kodit të Cilësisë" në arsimin e lartë. Ai përmban në mënyrë të detajuar të gjitha hapat, proceset, metodologjinë që do të përdoret në kuadër të realizimit të SKS. Çdo rishikim apo ndryshim në përmbajtje të tij, është objekt diskutimi nga ASCAL, BA dhe IAL dhe miratohet nga Bordi i Akreditimit.

Bazuar në ligjin nr. 80/15, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe VKM nr. 109, datë 15.02.2017, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit

*dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë", një nga mekanizmat kryesorë të sigurimit të jashtëm të cilësisë është vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet Sondazhit Kombëtar të Studentëve (SKS).*

SKS ka si qëllim kryesor sigurimin dhe rritjen e cilësisë në arsimin e lartë duke vlerësuar performancën e institucioneve të arsimit të lartë në kuadër të mësimdhënies, mësimnxënies dhe kompetencat, nëpërmjet pyetësorit kombëtar të studentëve. Po ashtu, me anën e këtij sondazhi, do të vlerësohen edhe aspektet e veçanta të operimit dhe funksionimit të IAL në kuadër të vendimarrjes dhe politikëbërjes në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

Objektivat kryesorë të SKS janë:

- Të japë në mënyrë periodike informacione reale e të besueshme ASCAL, BA dhe MASR për cilësinë e arsimit të lartë bazuar tek mendimi dhe opinioni i studentëve
- Të ndihmojë vendimarrjen dhe politikëbërjen në fushën e arsimit të me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë
- Të ndihmojë vetë institucionet e arsimit të lartë të përmirësojnë funksionimin dhe të rrisin cilësinë e tyre
- Të japë informacionet e nevojshme drejtuesëve të institucioneve, administratorëve etj, për hartimin e politikave të zhvillimit të institucioneve bazuar në nevojat dhe kërkesat e studentëve
- Të informojë me të dhëna të besueshme, studentët aktualë me cilësinë e arsimit të lartë në institucionet kua ata studiojnë. Po ashtu synon të ndihmojë studentët e rinj me informacione për cilësinë e mësimdhënies në IAL dhe programet e studimit ku ata duan të studiojnë.
- Të informojë publikun në tërësi për cilësinë e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë

Sondazhe të ngjashme me SKS mund të zhvillohen kur inicjohen nga ministria përgjegjëse për arsimin e lartë për qëllime specifike vlerësimi në fushën e arsimit të lartë

Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies së institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri nëpërmjet SKS kryhet në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar për arsimin e lartë dhe sigurimin e cilësisë dhe bazohet në praktikën më të mirë të ndjekur në vendet e zhvilluara. Meqënëse është një proces i rëndësishëm, realizimi i tij kërkon angazhimin dhe kontributin e disa institucioneve që janë pjesë e arsimit të lartë:

Bordi i Akreditimit i cili me propozim të ASCAL, shqyrton dhe miraton me vendim të posaçëm datën e nisjes së procesit të SKS, periudhën dhe afatet e zhvillimit të tij. Ky vendim u përcillet të gjitha institucioneve të arsimit të lartë. Po ashtu, BA shqyrton metodologjinë, procedurën / manualin e propozuar nga ASCAL ose miraton ndryshimet eventuale në manualin ekzistues. BA, informohet në mënyrë të vazhdueshme për zhvillimin e SKS. Në përfundim të procesit, BA analizon rezultatet paraprake të vëna në dispozicion nga ASCAL dhe miraton raportin përfundimtar të procesit. Në rast problematikash, propozon ndryshime/ përmirësime të Manualit, procedurës, kuadrit ligjor dhe politikëbërjes për përmirësimin e cilësisë në arsimin e lartë. BA, në bazë të rezultateve të SKS, kur nuk garantohet cilësia në mësimdhënie, kërkon nga ASCAL nisjen e proceseve të ndryshme të monitorimit në institucione të caktuara. Rezultatet e SKS, raporti analitike, vendimarrja dhe rekomandimet e BA, bëhen publike në përfundim të procesit.



Agjencia e sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, në bazë të nenit 104 Sigurimi i jashtëm i cilësisë, të ligjit 80/2015 për arsimin e lartë, ka një nga detyrat kryesore, procesin e vlerësimit të mësimdhënies, çdo tre vjet dhe të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme institucionet e arsimit të lartë përmes Sondazhit Kombëtar të Studentëve.

ASCAL është institucioni përgjegjës që harton procedurën, metodologjinë dhe instrumentet për zhvillimin e SKS. Bazuar në planin e punës, ASCAL harton kalendarin e aktiviteteve dhe planin e veprimtareive për zhvillimin e sondazhit kombëtar të studentëve. Ky plan i detajuar i propozohet BA për t'u miratuar dhe zhvilluar në vitin pasardhës. ASCAL garanton ecurinë e procesit duke vënë në dispozicion të GP, infrastrukturën e nevojshme logjistike, burimet njerëzore dhe financiare.

Të gjitha IAL që operojnë në fushën e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, kanë detyrim ligjor t'i nënshtrohen SKS sipas përcaktimeve të këtij manuali. IAL pas marrjes së njoftimit zyrtar për nisjen e procesit të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet SKS, konfirmon pjesëmarrjen në të si dhe ve në funksion të procesit të gjitha kapacitetet e nevojshme logjistike e humane që disponon. Institucioni nëpërmjet koordinatorit institucional ve në dispozicion të ASCAL listën e plotë të studentëve dhe adresat elektronike (e-mail). Gjatë fazës së plotësimit të pyetësorëve, IAL ve në dispozicion të studentëve dhe procesit, salla dhe laboratorë informatike në mënyrë që studentët të mund të plotësojnë pyetësorët. Në fillim të çdo viti akademik, IAL ve në dispozicion të ASCAL kontaktet zyrtare të drejtuesëve të këshillave studentore dhe ndihmon dhe ato të kryejnë takime informuese me studentët gjatë fazës së zhvillimit të SKS.

SKS është proces i cili ka për bazë studentin. Bazuar në LAL, në çdo institucion të arsimit të lartë, studentët duhet të jenë organizuar dhe përfaqësuar nga Këshillat studentore. IAL mbështesin organizimin dhe funksionimin e tyre në përputhje me këtë ligj. ASCAL bashkëpunon ngushtësisht me KS në institucionet e arsimit të lartë dhe me Këshillin Kombëtar të Studentëve (KKS). KS në çdo IAL, informohen për nisjen e procesit të vlerësimit të mësimdhënies nëpërmjet SKS.

ASCAL organizon takime informuese dhe diskutimi me përfaqësi të studentëve. Takimet mund të organizohen edhe në institucionet e arsimit të lartë në rastet kur kërkohen ka KS me qëllim informimin dhe trajnimin për aspekte teknike të studentëve. ASCAL para finalizimit të pyetësorëve, diskuton me KS dhe studentët, formatin e pyetësorëve<sup>1</sup>, fushat e vlerësimit, indikatorët dhe kriteret e vlerësimit, metodologjinë dhe analizën e rezultateve finale. Në përfundim të kësaj fazë, çdo KS-së e IAL përgatit propozimet eventuale për ndryshime dhe i dërgon ato zyrtarisht (në rrugë elektronike ose postare) në ASCAL. GP shqyrton të gjitha propozimet dhe i reflekton ato në versionin përfundimtar të pyetësorëve. Këshillat studentore kanë detyrim informimin e të gjithë studentëve për rëndësinë e procesit, përgjegjësinë ndaj institucionit për të dhënë përgjigje të sakta dhe reale, procedurën e plotësimit si dhe informimin rezultatet përfundimtare.

Tashmë ASCAL dhe BA kanë përgatitur gjithë infrastrukturën e nevojshme, dokumentin themelor *Manual për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet pyetësorit kombëtar të studentëve*.

---

<sup>1</sup> Shembuj pyetjesh dhe pyetësorësh

Është përgatitur seti i pyetjeve dhe versioni on line për shpërndarjen e pyetësorëve. Ndërkohë ASCAL është në komunikim të vazhdueshëm me IAL për vënien në dispozicion të kontakteve të studentëve si dhe me vetë studentët për njohëjen me procesin në tërësi.

Plani i veprimtarive të parashikuar anë kuadër të këtij procesi janë paraqitur në tabelën e mëposhtme

Fazae zhvillimit të SKS në vitin 2018	Fillimi / Kohëzgjatja
1. Hartimi projekt i propozimit dhe miratimi nga BA	20 tetor – 30 tetor
	1 nëntor – 15 nëntor
	15 nëntor – 30 nëntor
2. Miratimi i procedurës së zhvillimit dhe pyetësorët e SKS	1 dhjetor – 15 dhjetor
	15 dhjetor – 30 janar
3. Shpërndarja e dhe plotësimi i pyetësorëve	1 shkurt – 25 shkurt
	1 mars – 30 mars
	1 prill – 30 prill
4. Mbledhja e të dhënave, filtrimi dhe përpunime statistikore, hartimi i databazës përmbledhëse	1 maj – 15 maj
	15 maj – 30 maj
5. Publikimi i rezultateve paraprake në portalin on line	1 qershor - 30 qershor
	1 korrik – 30 korrik
6. Përgatitja e dokumentacionit për shqyrtim dhe vendimarrje në BA, publikimi i raportit final, përmbyllja e procesit	1 shtator – 1 nëntor
	1 nëntor – 30 nëntor
	dhjetor

## KAPITULLI III.

### SISTEMI I RUAJTJES DHE ADMINISTRIMIT TË INFORMACIONIT DHE PROCEDURAVE NË ASCAL

#### 3.1 Sistemi i menaxhimit të ASCAL, AMS

Një detyrë e rëndësishme që kryen ASCAL në kuadër të sigurimit të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë është monitorimi i ecurisë së proceseve të ndryshme me fokus sigurimin e cilësisë bazuar në mbledhjen e të dhënave në kohë reale nga IAL dhe monitorimi i tyre në kohë reale. Aktualisht ASCAL disponon një nga platformat më të rëndësishme në vend në fushën e arsimit të lartë e cila përveç mbledhjes dhe ruajtjes së të dhënave mundëson kryerjen e disa procedurave/aktiviteteve kryesore në kuadrin e vlerësimit, akreditimit të institucioneve/programeve të arsimit të lartë si:

- Menaxhim të të gjitha procedurave të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit me ndërfaqe të dedikuara edhe në gjuhën angleze për shkak të angazhimit të ekspertëve ndërkombëtarë. Vlerësime të programeve/institucioneve në kuadrin e licencimit/hapjes së tyre. Vlerësime institucionale dhe programeve të reja në institucionet ekzistuese,
- vlerësime në kuadrin e akreditimeve të reja dhe periodike në IAL,
- analiza në arsimin e lartë të programeve dhe IAL-ve,
- menaxhim të komunikimeve elektronike e postare,
- menaxhim shërbimesh nga IAL, evoluim në kohë të proceseve në etapa të ndryshme,
- informacion të besueshëm në kohe reale, menaxhim të proceseve të renditjes, klasifikimit e akreditimit, analiza, komunikim midis punonjësve,
- menaxhim efektiv, detyra në kohë,
- komunikim me institucionet, komunikim me ekspertët,
- realizimi i vlerësimit *on-line* për IAL dhe programe nga ekspertë vendas dhe të huaj si dhe vënia në dispozicion e mjaft dokumenteve e të dhëna *on-line* nga IAL,
- plotësim të pyetësorëve dhe publikimi i rezultateve
- version “*mobile application*”, për AMS,
- akses për përdoruesit (BA, IAL dhe ekspertët) i cili mundësohet nëpërmjet modulit *on-line* me mundësi aksesimi sipas hierarkisë dhe funksionit të përdoruesëve.

Gajtë procesit të akreditimit institucional, operimi nëpërmjet AMS ka qënë mjaft efikas jo vetëm për faktin se u arrit komunikimi në kohë reale i të gjithë aktorëve të procesit, por se ky komunikim u zhvillua tërësisht në gjuhën angleze.

Ky përditësim në AMS e lehtësoi jashtëzakonisht menaxhimin e procesit të akreditimit duke patur parasysh sasinë e informacionit të administruar dhe specifikën e gjuhës angleze.

AMS në të gjitha sondazhet e zhvilluara me IAL dhe ekspertët e vlerësimit, merr vlerësimin maksimal për lehtësinë, efikasitetin, transparencën dhe mundësitë që ofron për proceset që menaxhohen nëpërmjet këtij sistemi.

### 3.2 Administrimi i proceseve të vlerësimit nëpërmjet AMS dhe monitorimi i cilësisë

Aktualisht ASCAL menaxhon aktivitetin e vet nëpërmjet AMS. Në total, ASCAL realizon nëpërmjet AMS 19 lloje procedurash të aktivitetit të përditshëm. Deri tani janë rreth 2200 shërbime/procese/procedura (akreditime, vlerësime, raportime etj) që janë menaxhuar apo në proces menaxhimi nga AMS. Rëndësia më e madhe qëndron në menaxhimin e procedurave të vlerësimit dhe akreditimit. Në bazë të *“Manualit për procedurën dhe afatet për vlerësimin e cilësisë për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe të programeve të studimit”*, janë digjitalizuar të gjitha hapat që ndiqen në një procedurë vlerësimi për akreditimin institucional ose të programeve të studimit.

Nëpërmjet AMS, aktualisht për një procedurë akreditimi ndiqen hapat si vijon:

- Aplikimi për akreditim institucional gjatë çdo viti akademik, brenda periudhës 1 tetor – 31 maj por të paktën 1 vit para diplomimit të studentëve të parë për institucionet e reja apo përfundimit të akreditimit të parë ose akreditimit periodik. Koordinator i IAL ka kryer njëkohësisht aplikimin *on-line* nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të ASCAL (*ASCAL Management System – AMS*), në të cilin kanë akses të gjitha institucionet e arsimit të lartë. Në formularin e aplikimit, përveç të dhënave bazë të institucionit, IAL propozon edhe periudhën më të përshtatshme për IAL për kryerjen e akreditimit institucional. ASCAL dhe BA marrin në konsideratë ose jo periudhën e propozuar në varësi të agjendës vjetore të tyre dhe specifikave të IAL. E njëjta procedurë ndiqet edhe rastin e akreditimit periodik.
- ASCAL shqyrton paraprakisht përputhshmërinë ligjore të kërkesës së akreditimit dhe verifikon bazën ligjore të funksionimit të institucionit nga data e themelimit (për institucionet me akreditim të parë) dhe nga data e akreditimit paraardhës. Kjo mundësohet nga AMS pasi i gjithë informacioni dhe dokumentacioni për çdo IAL tashmë është i regjistruar dhe lehtësisht i verifikueshëm.
- Miratimi i periudhës së akreditimit nëpërmjet letrës të konfirmimit për fillimin e procesit të akreditimit duke përcaktuar periudhën e akreditimit (datën e fillimit dhe mbarimit të procesit). Në AMS specialisti i ASCAL përcakton planin e aktiviteteve me datat përkatëse për secilin prej tyre. IAL ndjek në kohë reale nëpërmjet llogarisë së vet ecurinë dhe realizimin e çdo faze të akreditimit.
- Vlerësimi i brendshëm nga GVB dhe IAL kryhet brenda 4 – 6 javëve, GVB dhe IAL përgatisin dosjen e akreditimit sipas listës së dokumentave të kërkuar nga ASCAL. Këto materiale ngarkohen edhe në formë elektronike në AMS
- Gjatë periudhës së përgatitjes të dokumentacionit dhe hartimit të raporteve, ASCAL përgatit pyetësorët *on-line* për stafin akademik dhe studentët dhe i kontakton individualisht nëpërmjet *e-mail*-it duke u kërkuar plotësimin *on-line* të pyetësorëve respektivë. Në *e-mail* dërgohen gjithashtu të dhënat për aksesin e pyetësorëve (adresa dhe kodi personal). Formatet elektronike të pyetësorëve në versionet shqip dhe anglisht janë përgatitur nga ASCAL gjatë vitit 2015 (shih aneks 4)
- Vlerësimi i jashtëm është faza kryesore e procesit të akreditimit, e cila realizohet nga ASCAL:
  - o Ngritja e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ,

- informimi i GVJ dhe vlerësimi i materialeve,
  - vizita në IAL,
  - raporti i vlerësimit të jashtëm dhe përgatitja e materialeve, janë disa nga proceset që menaxhohen nga AMS. Po ashtu ekspertët kanë akses në dokumentacionin paraprak të dorëzuar nga IAL dhe janë në kontakt midis tyre nëpërmjet AMS.
- Shqyrtimi i dokumentacionit nga Bordi i Akreditimit dhe vendimarrja për akreditimin. Anëtarët e BA kanë akses në materialet e përgatitura për shqyrtim për një proces të caktuar akreditimi. Shqyrtimi paraprak i tyre lehtëson vendimarrjen në mbledhjet e BA.

Në çdo hap të procesit të akreditimi, stafi i ASCAL është në kontakt të vazhdueshëm me kordinatorët e IAL duke shkëmbyer informacione dhe dokumente. Ndjekja në kohë reale e procesit, ndihmon të gjithë aktorët të koordinojnë me mirë aktivitetet duke fituar kohë dhe njëkohësisht duke rritur transparencën.

Një aspekt i rëndësishëm që IAL aplikojnë nëpërmjet AMS është protali i shërbimeve *on-line*. Nëpërmjet këtij portali, kordinatorët kërkojnë nga ASCAL fillimin e proceseve që lidhen me shërbimet që agjencia apo BA ofron për institucionet e arsimit të lartë. Çdo aplikim për shërbim lidhet me një procedurë/proces të brendshëm të ASCAL dhe në këtë mënyrë IAL ndjek në kohë reale ecurinë e tij. Po ashtu, nëpërmjet AMS, kordinatori i IAL dërgon dhe merr informacione për çdo aspekt apo njoftim që vjen në adresë të IAL.

Referuar të dhënave që ASCAL disponon, dhe nga deklarimi i IAL, agjencia monitoron vazhdimisht cilësinë në IAL.

Në çdo fillim viti akademik, institucionet nëpërmjet kordinatorëve, japin informacion në AMS për stafin akademik për vitin akademik, largimet dhe rekrutimet e mundshme, ndryshimet eventuale strukturore, programet aktive dhe jo aktive, studentët që ndjekin studimet për këtë vit akademik në çdo program studimi etj. ASCAL bën krahasimet e të dhënave në përputhje me standartet dhe kriteret për sigurimin e cilësisë dhe për disa institucione ka kërkuar informacione shtesë ose saktësim të dhënash. Analizat rast pas rasti janë dërguar titullarit të ASCAL dhe Bordit të Akreditimit.

Në ligjin e ri të arsimit të lartë, monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë është një nga detyrat themelore të ASCAL. Për këtë arsye, të gjitha mekanizmat e ngritur nga ASCAL do të jenë mjaft të rëndësishme, edhe në të ardhmen, pasi mundësojnë ndjekjen dhe monitorimin në kohë reale të ecurisë së çdo institucioni të arsimit të lartë.

Si rezultat i informacionit të mbledhur në vite, aktualisht stafi i ASCAL ka mundur krijimin e databazës më të madhe të arsimit të lartë në vendin tonë. Në këtë databazë, vetëm gjatë dy viteve të fundit janë hedhur për procesin e akreditimit institucional, janë administruar rreth 6000 dokumente të ndara sipas llojit, kategorisë, gjuhës etj.

Po ashtu nëpërmjet AMS, janë regjistruar një numër i madh komunikimesh ndërmjet ASCAL, BA, ekspertëve dhe IAL si dhe janë shkëmbyer mjaft dokumente shtesë ose informuese.

I gjithë informacioni, i ruajtur në AMS, është lehtësisht i administrueshëm dhe i përdorshëm në funksion të çdo procesi/procedure dhe aktiviteti të ASCAL/BA por mund të shërbejë edhe për procese të ndryshme vlerësuese analitike për aspekte të ndryshme në fushën e arsimit të lartë si p.sh kur në disa raste, BA ka ndërprerë procesin e vendimmarrjes deri në plotësimin e informacioneve të munguara.

### 3.3. Informimi dhe publikimi i informacionit

Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, në funksion të transparencës dhe informimit të publikut ka qënë e fokusuar gjerësisht në implementimin metodave të reja (kryesisht teknologjisë) dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tyre. ASCAL ka aktualisht një sistem mjaft të konsoliduar për dhënien e informacionit dhe informimine publikut. ASCAL përdor forma të ndryshme informimi bazuar në legjislacionin shqiptar për të drejtën e infomimit.

Në përputhje me Neni 7 të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” është përgatitur programi i transparencës për ASCAL i aksesueshëm për këto në faqen zyrtare të institucionit.. Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së ASCAL/KA, nëpërmjet pasqyrimin të detajuar të tij në faqen zyrtare [www.ascal.al](http://www.ascal.al) si dhe në mjediset e pritjes së publikut. Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentin.

Në përmbajtje të programit të transparencës të bërë publik, evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron *menu*-të ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në versionin e plotë. Në këtë program transparence, ASCAL ka paraqitur gjithashtu mekanizmin dhe formën e dhënies së informacionit, si dhe kontaktet zyrtare për marrjen e informacionit elektronik. Refruar regjistrin të dhënies së informacionit, për vitin 2016 dhe 2017, ASCAL është përgjigjur zyrtarisht dhe ka dhënë informacion / dokumente, për 400 kërkesa.

Pas riorganizimit të institucionit nga APAAL në ASCAL, agjencia ndryshoi faqen zyrtare dhe njëkohësisht formën e paraqitjes së informacionit. Faqja zyrtare e ASCAL është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun në format lehtësisht të kuptueshëm. Dokumentacioni i bërë publik, është i përditësuar vazhdimisht në formë e përmbajtje. Faqja e ASCAL lexon të dhënat në kohë reale nga databaza e institucionit duke garantuar në këtë mënyrë përditësim të informacionit për publikun në kohë reale sapo një vendim merret, raport publikohet apo aktivitet realizohet.

Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/ subjekteve të të dhënave, etj.

Disa informacionet të rëndësishme të dhëna nëpërmjet faqes zyrtare janë:

- Dokumentacioni për vlerësimin dhe akreditimin me informacione të detajuara për çdo proces të zhvilluar nga çdo IAL, qoftë publik apo privat

- Akte ligjore, dokumenti zyrtar për çdo IAL është krijuar për të publikuar të gjitha dokumentet zyrtare si vendime të KM dhe BA, Urdhëra të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, Raporte të vlerësimit të ekspertëve të jashtëm etj.
- Në faqen zyrtare janë të publikuara të gjitha këto dokumente në gjuhët shqip dhe anglisht. Po ashtu standardet shtetërore të cilësisë për të tre ciklet e studimit, janë në versionin elektronik dhe të printuar dhe u shpërndahen vazhdimisht IAL që janë në proces vlerësimi dhe akreditimi, raportet e vlerësimit në shqip dhe anglisht etj
- Raporte vjetore, analitike të ASCAL dhe BA, etj

Kërkesat për informacion ose dokumente janë të fokusuara kryesisht në versionin elektronik, si AMS, *e-mail* etj, dhe përgjigjet e dhëna kanë qënë nëpërmjet tyre. Stafi i ASCAL ka dhënë një numër të madh informacione nëpërmjet AMS (kryesisht për IAL, BA dhe ekspertët) dhe mjaft *e-mail*-e për publikun në tërësi. Një pjesë e informacionit, është dhënë nëpërmjet raporteve informuese ose vjetore.

Nëpërmjet faqes së ASCAL, përdoruesit mund të aksesojnë direkt sistemin e menaxhimit Gjithashtu në këto faqe ka dhe portale dhe module të tjera të dedikuara për dhënien e një informacioni sa më të qartë dhe të hollësishëm për publikun. Përparësia kryesore e këtij modeli, është komunikimi dhe ndërveprimi i publikut me faqen e internetit duke krijuar mundësinë e marrjes së informacionit të dëshiruar.

### **3.4. Sistemi i ruajtjes, arkivimit të informacionit dhe i shërbimeve në ASCAL**

Procesi për menaxhimin dhe administrimin e informacionit/dokumentacionit në ASCAL kryehet nga arkiva/protokolli i institucionit. Çdo dokument ruhet në formë elektornike dhe të shkruar në arkivën dhe databazën e institucionit. ASCAL protokollon dhe ruan çdo dokument zyrtar në përputhje me Ligjin Nr. 9154, datë 06.11.2003, “*Për arkivat*”. Në bazë të këtij ligji dhe të akteve të tjera të ruajtjes së informacionit zyrtar, ASCAL klasifikon informacionin sipas statusit të tij, publik, përdorim të brendshëm, konfidencial, dhe sekret. Po ashtu dhe aksesit i tij nga stafin e ASCAL, BA dhe ekspertët, bëhet në funksion të procesit/procedurës së cilës i përket, dokumentacioni në fjalë. Aspekte të përdorimit të informacionit të brendshëm të ASCAL dhe mënyrës së dhënies së tij, janë përcaktuar në rregulloren e brendshme të ASCAL, të miratuar në vitin 2014.

Në funksion të proceseve të vlerësimit dhe akreditimit, tashmë, së bashku me dosjen e printuar, në ASCAL dorëzohet edhe versioni elektronik i saj.

Përsa i përket kapaciteteve logjistike dhe bazës materiale, ASCAL ka disa mangësi. Infrastruktura dhe ambientet e punës, janë të vjetra dhe nuk i përmbushin standartet e një agjencie që aspiron të bëhet anëtare e ENQA. Rrejtja e brendshme kompjuterike për stafin dhe anëtarët e BA është funksional por mjaft i amortizuar. Bordi i Akreditimit nuk ka një zyrë të posaçme ku të zhvillojë mbledhjet e veta, por në mungesë të saj, në disa raste aktiviteti kryhet në zyrën e titullarit të ASCAL. Pajisjet kompjuterike që i mundësojnë anëtarëve leximin e dosjeve në versionin elektronik apo hartimin e dokumenteve të tjera prej tyre, mungojnë. Çdo vit ASCAL, ka kërkuar përmirësimin e bazës materiale të ASCAL/BA dhe rikostruksioni i të

gjitha ambienteve dhe mjediseve të punës së ASCAL. Gjithashtu, është e nevojshme ristrukturimi i sallës së mbledhjeve të Bordit të Akreditimit me parametrat normalë të punës, e cila të mundësojë gjithashtu dhe realizimin e mbledhjeve/ takimeve *online* me anëtarët e huaj që s’janë prezent ose me ekspertët e huaj të vlerësimit. Vlerësimi i brendshëm që do të kryejë ASCAL në kuadrin e anëtarësimit në ENQA, është i fokusuar dhe në kapacitetet logjistike e financiare që zotëron agjencia, dhe si e tillë është një indikator mjaft i rëndësishëm për hapat e mëtejshëm të anëtarësimit në ENQA.



## KAPITULLI IV.

### AKTIVITETE TË TJERA TË ZHVILLUARA NGA ASCAL DHE BA

#### 4.1 Aktivitet i Bordit të Akreditimit

Bordi i Akreditimit ushtron aktivitetin e vet në ambiente të siguruara nga ASCAL. Mbledhjet e BA organizohen në bazë të një kalendari të hartuar në përputhje me numrin e aplikimeve që janë për t'u shqyrtuar.

Në lidhje me aktivitetin kryesor të BA, disa nga veprimtaritë kryesore të zhvilluara gjatë periudhës 2016 – 2017, përmendim:

#### - Veprimtaria e KA 2016

Viti 2016 ka qënë dhe viti i fundit kur ka funksionuar Këshilli i Akreditimit, KA, i cili u riorganizua në Bordi i Akreditimit, me VKM Nr. 109, datë 15.02.2017, në përputhje me ligjin 80/2015.

Gjatë këtij viti, KA ka zhvilluar veprimtarinë e tij, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e programeve të studimit dhe institucioneve të arsimit të lartë si dhe hapjes së programeve të reja të studimit. Në 8 mbledhjet e zhvilluara, KA ka marrë 103 vendime për hapjen, akreditimin dhe përmbushjen e kushteve në kuadër të akreditimit të programeve dhe IAL-ve, sikundër jepen në tabelën 2.

	07 Janar*	18 -19 Shkurt	1 Prill	16 -17 Maj	07 - 08 Korrik	17 - 18 Tetor	18 - 19 Nëntor	16 - 17 Dhjetor	Total
IAL Privat	-	15	10	14	17	5	-	-	61
IAL Publik	-	4	2	1	1	1	5	6	20
Follw Up/ Tjetër	-	4	-	-	6	4	5	3	20
Total	-	23	12	15	24	10	8	9	103

\*Në mbledhjen e jashtëzakonshme të KA, 07 Janar 2016, nuk ka patur vendimmarrje.

- *Veprimtaria e BA 2017*

Bordi i Akreditimit është një organ kolegjal vendimmarrës dhe i pavarur në veprimtarinë e tij, i cili funksionon pranë ASCAL bazuar në VKM Nr. 109 datë 15.02.2017. Bordi i Akreditimit (BA) është i përbërë nga 11 anëtarë nga të cilët minimalisht 3 dhe maksimalisht 5 duhet të jenë të huaj. BA u emërua me urdhër të Kryeministrit Nr. 32 datë 17.03.2017 dhe organizoi mbledhjen e tij të parë në datën 07.04.2017. Vendimi i parë që Bordi ka marrë në këtë mbledhje ishte “*Mbyllja e procedurave të mbartura për shkak të riorganizimit të Institucioneve të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë*”, për arsye të riorganizimit të Institucioneve (ASCAL-BA) BA vendosi të marrë në shqyrtim dhe të përmbyllë procedurat e papërfunduara dhe/ose të mbetura pezull si dhe kërkesat e depozituara në ASCAL përpara fillimit të veprimtarisë së këtij Bordi.

Në total gjatë vitit 2017, Bordi i Akreditimit zhvilloi 7 mbledhje dhe janë marrë 130 vendime në kuadër të licencimit, akreditimit, riorganizimit të IAL-ve apo programeve etj. I gjithë aktiviteti pasqyrohet në tabelën 3.

TABELA 3. MBLEDHJET E BA 2017								
	7 – 8 Prill	19 Maj	10 Korrik	21 – 22 Shtator	20 – 21 Tetor	10 – 11 Nëntor	15 Dhjetor	Total
IAL Privat	2	35	10	18	8	12	14	99
IAL Publik	5	1	0	9	1	0	1	17
Follow Up/ Tjetër	5	0	2	1	2	0	4	14
<b>Total</b>	<b>12</b>	<b>36</b>	<b>12</b>	<b>28</b>	<b>11</b>	<b>12</b>	<b>19</b>	<b>130</b>

Një nga funksionet e tjera të Bordit të Akreditimit është miratimi i listës së ekspertëve, kjo listë pasi miratohet nga Bordi i Akreditimit regjistrohet në databazën e sistemit të ASCAL.

Gjatë vitit 2017, Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, përveç mbledhjeve kanë organizuar edhe aktivitete në kuadër të hartimit të standardeve të reja të cilësisë. Një nga këto aktivitete është seminari me temë "*Diskutimi i standarteve të reja të sigurimit të cilësisë*" me përfaqësues të Institucioneve të Arsimit të Lartë, më datë 14.12.2017.

Një nga funksionet e tjera të BA është miratimi i listës së ekspertëve dhe dokumenteve zyrtarë të funksionimit të ASCAL. BA ka miratuar “*Manualin për afatet dhe procedurën e vlerësimit për akreditimin e institucioneve dhe programeve të studimit në arsimin e lartë*”. Bazuar në ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 109 datë 15.02.2017, pas shqyrtimit të Draft- Manualit në mbledhjen e tij të datës 10.07.2017 dhe reflektimit të ndryshimeve të propozuara nga Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, miratohet këtë manual në mbledhjen e datës 20.10.2017.

Në Bordin e Akreditimit është paraqitur gjithashtu lista emërore e ekspertëve të vlerësimit të jashtëm për vitin 2015. Pas shqyrtimit paraprak, kjo listë është miratuar dhe regjistruar në databazën e sistemit të ASCAL.

Përfaqësues të BA në disa raste kanë qënë pjesë e grupeve të punës me qëllim verifikimin e plotësimin të kushteve të vëna nga BA për institucione të ndryshme apo në kuadër të riorganizimi institucional.

Bordi i Akreditimit, në çdo aktivitet, ka mbështetjen financiare dhe logjistike të ASCAL. Një nga specialistët e agjencisë luan rolin e sekretariatit të BA, i cili kryhen ndër të tjera këto funksione: përgatit agjendën e mbledhjeve dhe e propozon/kërkon aprovimin e anëtarëve, njofton anëtarët e Bordit të Akreditimit (për agjendën, në mbledhjen përkatëse dhe materialet që do të shqyrtohen etj.), përgatit dosjet dhe harton vendimet për programe/institucione private dhe programe/institucione publike, përgatit dosjet dhe harton vendime dhe dokumente të tjera zyrtare të BA, informon Bordin e Akreditimit me kërkesat e reja për akreditim, dërgon listat e ekspertëve, të propozuar nga Drejtori i ASCAL, komunikon në emër të BA me institucionet e tjera, regjistron minutat e mbledhjeve dhe e dërgon për miratim tek anëtarët e BA etj. I gjithë ky aktivitet dokumentohet dhe regjistrohet në AMS nëpërmjet procedurës *“Mbledhje të Bordit të Akreditimit”*. Anëtarët e BA, nëpërmjet llogarive në AMS kanë akses në të gjithë materialet dhe informacionet e vëna në dispozicion nga sekretariati i BA. Aktiviteti financiar i BA sigurohet nga ASCAL, nga të ardhurat e vlerësimit dhe akreditimit. Në këto shërbime përfshihen pagesat/honoraret për çdo pjesëmarrje, udhëtimet, akomodimi etj. Asistenca logjistike si kancelari, printer, fotokopje, kompjutera, internet, akses në AMS etj, po ashtu sigurohen nga ASCAL.

## **4.2. Bashkëpunimi me institucionet e arsimit të lartë ose të tjera në vend**

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë ka kontakte të drejtpërdrejta dhe të vazhdueshme me të gjitha institucionet që operojnë në fushën e arsimit të lartë si psh. Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), Institucionet e Arsimit të Lartë në vend (IAL) dhe me aktorë të tjerë në fushën e arsimit të lartë si dh institucione të tjera politikëbërëse në vendin tonë

Bashkëpunimi me IAL në vend ka qënë i vazhdueshëm gjatë këtyre 2 viteve për shkak të realizimit të një prej proceseve më të rëndësishme në vend sikundër është akreditimi institucional me QAA.

Përveç kontakteve të vazhdueshme, informimit për çdo dokumentacion apo ndryshime të reja, ASCAL ka kontakt të drejtpërdrejtë nëpërmjet AMS me koordinatorët e çdo IAL. Çdo komunikim, informacion, dokumentacion etj, bëhet në kohë reale dhe është i dokumentuar në sistemin e menaxhimit. ASCAL për shkak të ndryshimeve të reja ligjore, në proceset e menaxhimit dhe administrimit të informacionit, vlerësimit dhe akreditimit, në hartimin e dokumenteve të reja, përveç komunikimit ka kryer disa takime/seminare informuese me koordinatorët e institucioneve, drejtuesit e njësisive të sigurimit të cilësisë sii dhe me studentët. Asistencë teknike dhe trajnime të vazhdueshme janë kryer për njësitë e vlerësimit të brendshëm në IAL, trajnime për hartimin raporteve të vlerësimit të brendshëm në përputhje me standardet e reja të cilësisë. Për këtë periudhë dy vjeçare, ASCAL ka kryer rreth 35 trajnime të grupeve të brendshme të sigurimit të cilësisë për akreditimin institucional dhe rreth 70 trajnime për grupet e vlerësimit të brendshëm të institucioneve të cilët kanë zhvilluar ose janë në proces akreditimi programeve të studimit.

Bashkëpunimi me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka qënë mjaft efikas gjatë kësaj periudhe 2 vjeçare. Stafi i ASCAL ka qënë pjesë e vazhdueshme e grupeve të punës në hartimin e drafteve të akteve nënligjore, të grupeve në kuadër të verifikimit të infrastrukturave pritëse të Universiteteve sipas kuotave të deklaruara të studentëve, etj.

Po ashtu bashkëpunime ka patur në kuadër të njohjes së diplomave, programet e akredituara për QSHA dhe Qendrën e kërkimit shkencor, RASH etj

Komunikim të vazhdueshëm ASCAL ka patur edhe me institucione të tjera, jo pjesë e arsimit të lartë si: Departamenti i Administratës Publike, Agjencia e Prokurimit Publik, etj.

## **4.3. Bashkëpunimi i ASCAL me rrjetet ndërkombëtare të agjencive të sigurimit të cilësisë**

ASCAL, është anëtare me të drejta të plota në CEENQA Network, INQAAHE, dhe prej vitit 2010 është anëtare e asociuar e ENQA. Agjencia ka bashkëpunuar aktivisht me këto rrjete, ka marrë pjesë në të gjitha veprimtaritë e tyre dhe veçanërisht në aktivitetet e organizuar nga ENQA. Fokus i veçantë i është kushtuar aktiviteteve që promovojnë cilësinë apo mekanizmat e sigurimit të cilësisë si dhe aktivitetet që sjellin të reja përsa i përket zhvillimeve në fushën e arsimit të lartë dhe sigurimit të cilësisë.

Një kontribut në promovimin e aktivitetit të ASCAL dhe ndryshimeve në arsimin e lartë në këto dy vite, ka qënë procesi i akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë me agjencinë

britanike QAA. Ky proces ka ndihmuar ASCAL të paraqitet denjësisht në mjaft evente të organizuara në fushën e arimit të lartë dhe sigurimit të cilësisë.

Gjatë gjithë këtyre aktiviteteve, ASCAL ka prezantuar, paraqitur dhe informuar bashkëpunorët e saj për aktivitetet që kryen dhe angazhimet për anëtarësimin e me të drejta të plota në ENQA dhe regjistrimi në EQAR. Përfundimet e nxjerra nga këto aktivitete kanë qënë objekt diskutimi në ASCAL dhe janë reflektuar në aktivitetin e agjencisë apo në aktet zyrtare të saj sikundër është reflektimi i disa ndryshimeve në procedurën e akreditimit bazuar në ESG 2015. Po ashtu ASCAL ka përgatitur informacione për publikim në *newsletters* periodike, të publikuar nga partnerët e bashkëpunorët, rreth zhvillimeve të fundit në arsimin e lartë në kuadër të ligjit të ri dhe akreditimit institucional. Bashkëpunimi me institucionet partnere ka qënë i fokusuar edhe në propozimin e ekspertëve të vlerësimit apo për pjesmarrje në projekte të përbashkëta.

Gjithashtu, ASCAL ka shprehur interes për bashkëpunim, propozimeve për pjesmarrje në projekte të ndryshme të aplikuara nga institucione partnere. Të gjitha këto janë në fazën e aplikimit dhe në rast se shpallen fituese, ASCAL do të publikojë informacione të detajuara në faqen zyrtare të internetit.

#### 4.4 Aktiviteti Financiar i ASCAL dhe BA, 2016 dhe 2017

ASCAL në zbatim të ligjit Nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, Ligji 130/2016 “Për buxhetin e vitit 2017”, Udhëzimit Nr.2 datë 06.02.2012 të Ministrit të Financave “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar, shkresat e Ministrisë së Financave Nr. 17911/68, datë 10.01.2017 “Dërgohet detajimi i shpenzimeve korente për vitin 2017” ka kryer dhe mbështetur aktivitetin e saj financiar, përpilon realizimin e shpenzimeve sipas klasifikimit buxhetor. Tabelat e realizimit të shpenzimeve rakordohet me Degën e Thesarit Tiranë për çdo muaj dhe dërgohet në MAS çdo tremujor e vulosur nga Dega e Thesarit Tiranë së bashku me raportimin e monitorimit shoqëruar me pasqyrat përkatëse.

Në mbështetje të Ligjit Nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, “Për buxhetin e vitit 2017”, shkresës e MASR “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm (PBA) 2018-2020”, gjatë muajit korrik-gusht 2017 sektori i shërbimeve dhe financa ka përgatitur gjithë materialin e kërkuar për hartimin e projektbuxheti i vitit 2018.

APAAL/ASCAL bazuar në VKM 424 datë 02.06.2010 “Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë”, i ndryshuar dhe në Udhëzimin nr. 29/1, datë 16.08.2011 “Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve që kryen Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.109 datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë” të ardhurat e arkëtuara nga shërbimet e realizuara nga APAAL/ASCAL shpërndahen 10% në buxhetin e shtetit dhe 90% në buxhetin e Agjencisë. Pjesa e të ardhurave që i takon APAAL/ASCAL, evidentohet, autorizohet dhe përdoret me strukturë të vecantë buxhetore kapitulli 6, “Të ardhura jashtë limitit”.

Çdo muaj për arkëtimet e ASCAL bëhet akt-rakordimi me Degën e Thesarit Tiranë nënshkruar nga punonjësja e Degës së Thesarit dhe specialistja e financës së ASCAL. Nga sa më sipër në vijim, jepet informacion i detajuar mbi të ardhurat, realizimet sipas zërave të përcaktuar në bazën ligjorë të sipërcituar:

APAAL/ASCAL ka në buxhetin e saj për vitin 2017 : 20.900.000 lekë, fonde sipas zërave (paga art.600; sigurimet shoqërore art. 601; shpenzime operative, art. 602).

#### **Buxheti dhe realizimi viti 2017**

N r.	Ka pitulli	Emërtimi	Llogaria ekonomike	Plani në lekë	Plani I rishikuar I buxhetit	Fakti vlera në lekë
1	1	Paga	6000000	15.000.000	15.000.000	13.256.930

2	1	Sigurime shoqërore	6010000	2.200.000	2.400.000	2.115.455
3	1	Shpenzime operative	6020000	3.500.000	3.500.000	3.222.960
		Totali		20.700.000	20.900.000	18.595.345

Zëra të cilët janë realizuar në masën 88-90%.

***Të ardhura të arkëtuara për vitin 2017***

Kap.	Artikulli	Lloji i të ardhurave	Arkëtuar	Pjesa e Buxhetit	Pjesa e institucionit	Rritje e autorizuar
6	7190990	Shërbimet që kryen APAAL/ASCAL institucioneve të arsimit të lartë	57.839.438	5.783.944	52.055.494	52.055.494
6	7211100	Projekte	2.228.300	0	2.228.300	2.228.300
		Shuma	60.067.738	5.783.944	54.283.794	54.283.794

APAAL/ASCAL bazuar në VKM 424 datë 02.06.2010 “Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë”, i ndryshuar dhe në Udhëzimin nr. 29/1, datë 16.08.2011 “Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve që kryen Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.109 datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë” trashëgon të

ardhura në vitin 2017 në buxhetin e saj në vlerën e 172.078.113 lekë + 2.228.300 leke nga projektet = 174.306.414 lekë.

Sipas Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr.29/1 datë 16.08.2011 “Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve që kryen Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.109 datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë” 90% të të ardhurave të arkëtuara gjatë vitit 2017 janë përdorur:

- Për pagesat e ekspertëve të jashtëm, vendas ose të huaj dhe konsulentëve, të cilët janë kontraktuar nga APAAL/ASCAL;
- Për të mbuluar shpenzimet operative dhe të funksionimit të Bordit të Akreditimit
- Për pagesën e anëtarëve të Bordit të Akreditimit dhe shpenzime të tjera të tij
- Për pagesën e tarifave të anëtarësimit në organizata ose institucione ndërkombëtare

#### *Përdorimi i të ardhurave për vitin 2017*

Shpenzimet operative nga të ardhurat Llogaria ekonomike 602.0000			
Nr.	Emërtimi i shpenzimeve	Gjendja e trashëguar deri në dhjetor 2017	Përdorur në fakt
	Shpenzime operative	172.078.113	28.268.353
1	Shpenzime për pagesën e honorareve të Bordit të Akreditimit (Të huaj dhe vendas)		5.907.909
2	Shpenzime për pagesën e honorareve të ekspertëve vendas dhe të huaj dhe eksperte vendas të QAA		11.193.839
3	Shpenzime udhëtim e dieta brenda dhe jashtë shtetit të punonjësve të ASCAL, Bordit të Akreditimit dhe ekspertëve të huaj dhe eksperte të QAA.		8.296.483
4	Komisione bankare		192.567
	Shpenzime të ndryshme, qera salle etj		2.191.749



5	Shpenzime për pagesën e tarifave të anëtarësimit në organizatat		485.806
---	---	--	---------

Të ardhurat nga proceset e vlerësimit dhe akreditimit, ASCAL i përdor në funksion të tyre duke mundësuar pagesat finaciare të Bordit të Akreditimit dhe ekspertëve të jashtëm, tarifave të anëtarësimit në INQAAHE, CEENQA dhe ENQA dhe për aspekte të tjera që lidhen me këto procese. Në zërin *shpenzime operative*, përmendim pagesat për udhëtime dhe dieta të stafit për aktivitetet e zhvilluara jashtë vendit si dhe pagesat për anëtarët e Bordit të Akreditimit dhe ekspertët vendas dhe të huaj.

Gjatë vitit 2017 në ASCAL janë aktivizuar ekspertë vendas të kualifikuar për vlerësimin e programeve të studimit në arsimin e lartë. Janë bërë pagesat për:

1. Vlerësimi paraprak i programeve 2 vjecare profesionale:
  - a) 1. “Teknologjia e instalimeve elektrike” në Kolegjin Profesional të Tiranës; 2. “Edukimi për foshnjërinë dhe fëmijërinë e hershme” në Universitetin “Fan S. Noli” Korçë;
  - b) 1. “Dizajn grafik”, IAL “Metropolitan”.
2. Vlerësimi paraprak (heqje kushtesh) i programit të studimit të ciklit të parë: 1. Bsc. “Inxhinieri kompjuterike dhe teknologji informacioni” në Institutin Kanadez të Teknologjisë
3. Vlerësimi paraprak i programeve të studimit të ciklit të dytë:
  - a) M.p. “Administrim publik” Universiteti “Fan S. Noli” i Korçës;
  - b) M.p. 1 vjecar “Menaxhim në sport dhe turizëm”, në Universitetin e Sporteve
  - c) Msc. “Drejtësi në Universitetin “Epoka”
4. Vlerësimi paraprak (heqje kushtesh) i programeve të studimit të ciklit të dytë:
  - a) Msc. Integruar “Drejtësi në Universitetin “Epoka”;
  - b) Msc. “Inxhinieri kompjuterike dhe teknologji informacioni” me 3 profile:
5. Riorganizimi i programit të studimit të ciklit të dytë:
  - a) M.p. 2 vjecar “Mësuesi për arsimin e mesëm” në M.p. “Mësuesi edukimit fizik dhe shëndetësor në arsimin parauniversitar” në Universitetin e Sporteve
6. Vlerësimi paraprak (heqje kushtesh) i programeve të studimit të ciklit të tretë:
  - a) SPA. “Anesteziologji, reaminacion dhe terapi intensive”, SPA. “Sëmundje të aparatit kardiovaskular”, SPA. “Mjekësi transfuzionale”, SPA. “Nefrologji”, SPA. “Shkenca të ushqyerjes”, SPA. “Gastroenterologji”, SPA. “Kirurgji e përgjithshme”, SPA. “Ortopedi dhe traumatologji”, SPA. “Kardiokirurgji”, SPA. “Gjinekologji dhe obstetrikë” në Universitetin Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”

#### I. Në vitin 2017 janë kryer:

- 1 Vlerësimi i jashtëm në kuadër të akreditimit të programeve 2 vjecare profesionale:
  - a) Janë vlerësuar me ekspertë vendas programet 2 vjecare profesionale: 1. “Elektronikë”, 2. Teknologji ajrimi dhe kondicionimi”, 3. “Teknologji automjetesh”, 4. “Elektromekanikë” në Kolegjin Profesional të Tiranës;
2. Vlerësimi i jashtëm në kuadër të akreditimit të programeve të ciklit të parë:
  - a) Është vlerësuar me ekspertë vendas programi i studimit të ciklit të parë: 1. Bsc. “Infermier e Përgjithshme” në Universitetin “Aldent”
  - b) Janë vlerësuar me ekspertë vendas programet e studimit të ciklit të parë: 1. Bsc. “Drejtës”, 2. Bsc. “Psikologji” në Universitetin “Ësdom”

- c) Janë vlerësuar me ekspertë vendas programet e studimit të ciklit të parë: 1. Bsc. “Financë-bankë (shqip)”, 2.Bsc. “Financë-bankë (Anglisht)”, 3.Bsc. “Administrim biznesi”,4.Bsc.“Shkenca politike dhe marrëdhënie ndërkombëtare”, 5.Bsc.“Ekonomiks”,6.Bsc. “Inxhinieri ndërtimi”, 7.Bsc.“Inxhinieri kompjuterike” në Universitetin “Epoka”
- d) Janë vlerësuar me ekspertë vendas heqja e kushteve në programet e të studimit të ciklit të parë” 1.Bsc. “Menaxhim biznesi”, 2.Bsc.“Mësuesi për arsimin parashkollor”, 3.Bsc.“Mësuesi për arsimin fillor”, 4. Bsc. “Infermieri”, 5.Bsc. “Fizioterapi”, 6.Bsc. “Inxhinieri mekatronike”, 7.Bsc. “Anglisht”, 8.Bsc. “Financë-bankë”, 9.Bsc. “Psikologji e përgjithshme”, 10. Bsc. “Shkenca juridike”, 11. Bsc. “Shkenca politiko-administrative”, 12. Bsc. “Shkenca juridike”, 13. Bsc.“Dizajn multimedia” në “Albanian University”; 1. Bsc. “Financë-kontabilitet, në IAL “Marin Barleti”
7. Vlerësimi i jashtëm në kuadër të akreditimit të prograve të ciklit të dytë:
- a) Është vlerësuar me ekspertë vendas programi i studimit: 1.Msc.Integruar “Stomatologji” në Universitetin “Aldent”
- b) Është vlerësuar me ekspertë vendas programi i studimit” 1. Msc. “E drejtë civile dhe tregtare” në Universitetin “Mesdhetar i Shqipërisë”
- c) Janë vlerësuar me ekspertë vendas programi i studimit” 1. Msc. “Mësuesi në arsimin fillor” , 2. Msc. “Inxhinieri kompjuterike”, 3. Msc. “Inxhinieri mekatronike” 4. Msc. I integruar “Stomatologji”, 5.Msc. integruar “Farmaci”, 6. Msc. integruar “Arkitekturë” Universitetin “Albanian University”
- d) Janë vlerësuar me ekspertë vendas heqja e kushteve në programet e studimit të ciklit të dytë: 1. Msc. “Menaxhim në inxhinieri”, 2. Msc.”Inxhinieri elektrike” në Universitetin “Metropolitan Tirana” .
- e) Janë vlerësuar me ekspertë vendas heqja e kushteve në programet e studimit të ciklit të dytë: 1. Msc. “Inxhinieri mekatronike”, 2. Msc. “Teknologji informacioni”, 3. Mp. “Administrim biznesi”, 4. Mp. “Menaxhim bankar dhe financiar” 5.Mp. “Infermier e Përgjithshme”në Albanian University
8. Vlerësimi i jashtëm për heqjen e kushteve në kuadër të akreditimit të programeve të ciklit të tretë:
- a) Janë vlerësuar me ekspertë të huaj studimit të ciklit të tretë, 1. Dr. “Administrim biznesi”, 2. Dr. “Ekonomiks” me profile, 3. Dr. “Inxhinieri ndërtimi” dhe 4. Dr. “Marrëdhënie ndërkombëtare” për Universitetin “Epoka”.
- b) Është vlerësuar me ekspertë të huaj dhe vendas 1 program i studimit të ciklit të tretë Dr.”Psikologji Klinike” në “Albanian University”.

- b) Janë vlerësuar me ekspertë vendas 4 programe të studimit të ciklit të tretë, 1. SPA “Orthodonci”, 2. SPA “Kirurgji”, 3. SPA “Implantologji” dhe 4. SPA “Kirurgji OMF” në Universitetin “Albania University”

Mbështetur në ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM Nr.424 datë 02.06.2010 “Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë”, të ndryshuar, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL) dhe pas riorganizimit të saj në Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) është institucioni publik përgjegjës si e vetme dhe/ ose në bashkëpunim me agjenci të huaja, për vlerësimin e cilësisë për të gjitha institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri dhe programet e studimit që ato ofrojnë.

Referuar pikave 1.2,1.3, dhe 4.1 të “Kontratës së Përgjithshme të Projektit “ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Quality Assurance Agency for Higher Education (QAA-UK), shkresës së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit Nr.2064/1 Prot. datë 29/02/2016 “Lidhur me zbatimin dhe ekzekutimin e Kontratës së Përgjithshme ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Quality Assurance Agency for Higher Education (QAA-UK)” APAAL/ASCAL ngarkohet të ndjekë dhe zbatoj kontratën e lidhur ndërmjet MAS dhe QAA në proceset e vlerësimit për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri dhe kryerjen e pagesave përkatëse në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e parashikuara në kontratën e përgjithshme.

Pagesat janë kryer në përputhje të plotë me parashikimet për pagesë në OPC, (plani i aktiviteteve në shtojcën 4) dhe konkretisht si më poshtë:

**Pagesat e QAA sipas kontrates se MAS-QAA**

	100 %	10 %	40 %	50 %	Fatura Mars 2016	Fatura Korrik 2016	Fatura Nentor 2016	Fatura Prill 2017	Fatura Qershor 2017	Fatura Korrik 2017	Fatura Gusht 2017	Fatura Shtator 2017
Aktiviteti 1	73,500				73,500							
Aktiviteti 2	49,000				49,000							
Batch 1	131,600	13,160	52,640	65,800	13,160	52,640	65,800					
Batch 2	80,500	8,050	32,200	40,250				40,250		40,250		

Batch 3	54,600	5,460	21,840	27,300				27,300		27,300		
Batch 4	70,700	7,070	28,280	35,350				35,350		35,350		
Batch 5	82,600	8,260	33,040	41,300				41,300			41300	
Batch 6	84,000	8,400	33,600	42,000				42,000			42000	
Batch 7	82,600	8,260	33,040	41,300				8,260	33,040			41300
<b>TOTALI</b>	<b>709,100</b>	<b>58,660</b>	<b>234,640</b>	<b>293,300</b>	<b>135,660</b>	<b>52,640</b>	<b>65,800</b>	<b>194,460</b>	<b>33,040</b>	<b>102,900</b>	<b>83,300</b>	<b>41,300</b>

Gjatë vitit 2016 është bërë pagesa e aktiviteteve:

Nr. 1 “Methodology and handbook”	73.500 euro
Nr. 2 “Reviewer training”	49.000 euro
Nr. 3 A “-10% of batch 1 reviews”	13.160 euro
Nr. 3A “40% of batch 1 reviews”	52.640 Euro
Nr. 3A “50% of batch 1 reviews”	65.800 Euro

**Gjithsej 254.100 euro.**

Në vitin 2017 është bërë pagesa e aktiviteteve:

1. Aktiviteti 3B “10 % of batch 2”	me shumë 8.050 Euro
2. Aktiviteti 3B “40 % of batch 2”	me shumë 32.200 Euro
1. Aktiviteti 3B “10 % of batch 3”	me shumë 5.460 Euro
2. Aktiviteti 3B “40 % of batch 3”	me shumë 21.840 Euro
1. Aktiviteti 3B “10 % of batch 4”	me shumë 7.070 Euro
2. Aktiviteti 3B “40 % of batch 4”	me shumë 28.280 Euro
1. Aktiviteti 3B “10 % of batch 5”	me shumë 8.260 Euro
2. Aktiviteti 3B “40 % of batch 5”	me shumë 33.040 Euro

1. Aktiviteti 3B “10 % of batch 6” me shumë 8.400 Euro  
 2. Aktiviteti 3B “40 % of batch 6” me shumë 33.600 Euro

1. Aktiviteti 3B “10 % of batch 7” me shumë 8.260 Euro  
 1. Aktiviteti 3B “40% of batch 7” me shumë 33 040 euro

1. Aktiviteti 3B “50 % of batch 2” me shumë 40.250 Euro  
 2. Aktiviteti 3B “50 % of batch 3” me shumë 27.300 Euro  
 3. Aktiviteti 3B “50 % of batch 4” me shumë 35.350 Euro

1. Aktiviteti 3B “50 % of batch 5” me shumë 41.300 Euro  
 2. Aktiviteti 3B “50 % of batch 6” me shumë 42.000 Euro  
 3. Aktiviteti 3B “50 % of batch 7” me shumë 41.300 Euro

**Gjithsej 455.000 euro.**

**TOTALI 709. 100 Euro**

Me këtë vlerë kemi mbyllur kështu të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kontrata me QAA.

Pagesat e kryera janë konfirmuar nga përfaqësuesit e QAA.

Në mbështetje të Ligjit Nr.173/2013 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet KM të RSH dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanise së Madhe për shmangjen e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal për tatimin mbi të ardhurat”, udhezimit Nr.6, datë 10/02/2004 “Për marrëveshjet bilaterale për shmangjen e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal”, APAAL/ASCAL ka respektuar legjislacionin fiskal në Republikën e Shqipërisë.

Për zbatimin e kontratës së lidhur ndërmjet MAS dhe QAA, APAAL/ASCAL ka kryer shpenzimet operative si më poshtë vijon:

**Shpenzimet operative që rrjedhin nga ekzekutimi i kontratës së MAS-QAA**

Batch	Honorar/ Ekspertet vendas	Shpenzime Udhetimi/ Qendrimi ekspertet e QAA	Shpenzime Udhetimi/ Qendrimi ekspertet vendas dhe APAAL	Dieta ekspertet e QAA	Dieta ekspertet vendas dhe APAAL	Salla konferencash/ Trajnimi eksperteve	TOTALI/LEK	TOTALI/EURO
Batch 1	1,770,000	1,699,410	-	436,080	-	107,940.00	4,013,430	
Batch 2	940,000	502,130	45,000	251,160	37,500	70,990.00	1,846,780	
Batch 3	420,000	404,076	27,000	179,520	22,500		1,053,096	

Batch 4	1,000,000	663,716	77,970	263,840	40,000		2,045,526	
Batch 5	720,000	559,140	94,570	223,040	52,500		1,649,250	
Batch 6	750,000	528,943		237,600			1,516,543	
Batch 7	780,000	504,943		236,720			1,521,663	
<b>TOTALI</b>	<b>6,380,000</b>	<b>4,862,358</b>	<b>244,540</b>	<b>1,827,960</b>	<b>152,500</b>	<b>178,930</b>	<b>13,646,288</b>	<b>100,340</b>

Pra koste reale e Kontratës së Përgjithshme të Projektit “ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Britaninë e Madhe për ofrimin e shërbimeve të sigurimit të cilësisë për të mbështetur: krijimin e materialeve për vlerësimin e jashtëm të cilësisë, trajnimin e ekspertëve të vlerësimit dhe vlerësimin e jashtëm të institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri shkon në vlerën e :

**Totali i kontratës: 709,100 € + 100,340€ (shpenzimet operative)= 809.440 euro.**

Në zbatim të Ligjit Nr.7661 datë 19.01.1993 “Për kontabilitetin”, VKM Nr.248 datë 10.04.1998 “Për miratimin e Planit Kontabël Publik të Organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetërore Qendrore e Lokale si dhe njësisë që varen prej tyre”, Udhëzimit “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2017”, Shkresës së MAS gjatë muajit shkurt janë hartuar pasqyrat financiare për vitin 2017, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, i miratuar nga Dega e Thesarit Tirane dhe dorëzuar pranë MASR. Sektori i Shërbimeve dhe Publikimit është angazhuar në përpilimin e urdhërave dhe kontratave të ekspertëve që janë angazhuar në vlerësimin paraprak dhe vlerësimin e jashtëm institucional dhe të programeve të studimit në IAL. Në zbatim të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimit Publik”, Udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.4 datë 04.07.2012 “Për zhvillimin e prokurimeve me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit elektronik për autoritetet kontraktore dhe operator ekonomik” i ndryshuar, është hartuar regjistri i Prokurimeve Publike, është kryer procesi i prokurimeve për gjitha llojet e shërbimeve dhe detyrimet ndaj të tretëve. Në zbatim të këtij ligji është plotësuar realizimi i regjistrit të prokurimeve publike si 4, 8 dhe 12 mujor dhe është dërguar në MASR.

Një tjetër proces i zhvilluar gjatë 2017, ka qënë auditi financiar i realizuar nga MAS. Raporti i vlerësimit në lidhje me këtë aktivitet është dorëzuar në ASCAL. Referuar këtij raporti, aktiviteti financiar i APAAL, për periudhën objekt auditimi, rezultoi në përputhje me të gjitha aktet ligjore e nënligjore.

## KAPITULLI V

### PLANI I VEPRIMTARIVE PËR VITIN 2018

Plani i aktiviteteve për vitin 2018, është pjesë e planit të ndryshimeve të mëdha që lindin nga implementimi i ligjit të ri të arsimit të lartë. Ky plan afatshkurtër, fokusohet në dy drejtime kryesore: riorganizimi strukturor i institucioneve të sigurimit të cilësisë, ASCAL dhe BA dhe vazhdimësia e proceseve të vlerësimit dhe akreditimit. Plani afatshkurtër njëvjeçar i ASCAL, është pjesë e një plani afatmesëm i cili është duke u hartuar dhe përfshin objektivat kryesore të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë, në 3 vitet që vijnë. ASCAL përveç synimit kryesor, rritjen e cilësisë në arsimin e lartë, synon të anëtarësohet me të drejta të plota në Rrjetin Europian të Agjencive të Sigurimit të Cilësisë (ENQA) dhe regjistrohet në Regjistrin Europian të Agjencive (EQAR).

Referuar planit një vjeçar, për vitin 2018, ASCAL / ASCAL parashikon të zhvillojë aktivitetet si më poshtë:

a. *Finalizimin e procesit të riorganizimit bazuar në miratimin e strukturës së ASCAL*

Riorganizimi i ASCAL në ASCAL është procesi më i rëndësishëm dhe kompleks që sipas përcaktimeve të ligjit 80/2015, duhet të përfundojë brenda gjashtë muajsh nga hyrja në fuqi e tij. Edhe pse një pjesë e proceseve në funksion të riorganizimit kanë filluar ose janë në vazhdim prej 2015, në këtë drejtim në vitin 2018 parashikohet të:

- Hartohet draf Vendimi i Bordit të Ministrave së bashku me relacionin shpjegues për organizimin dhe funksionet e ASCAL.
- Hartohet draf Vendimi i Bordit të Ministrave së bashku me relacionin shpjegues për organizimin dhe funksionet e Bordit të Akreditimit.
- Hartohet draft rregullorja e jashtme për sigurimin e cilësisë së bashku me relacionin shpjegues.
- Dërgojë për miratim të vendimeve për ASCAL, BA dhe Rregullores së Jashtme të sigurimit të cilësisë.
- Miratojë strukturën organizative dhe rregulloret e brendshme të ASCAL dhe BA. Riorganizimi i brendshëm i ASCAL në përputhje me aktet e miratimit.
- Kontribuojë në hartimin e kodit të cilësisë së bashku me grupi e ekspertëve që do të angazhohen për këtë proces.

b. *Zhvillimi i procedurave të vlerësimit në kuadër të akreditimit të institucioneve dhe programeve.*

<b>Plani i punës në Sektorin e SPVC / ASCAL</b>	
<b>Viti 2018</b>	
Nr.	Aktivitetet/Lloji i programeve

1. Vlerësimi i jashtëm i cilësisë për akreditimin e parë dhe periodik të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimit
2. Vlerësimi paraprak në kuadër të hapjes dhe/ose riorganizimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit me kërkesë të ministrisë përgjegjëse për arsimin;
3. Vlerësimi paraprak dhe njohja e programeve të studimit, të ofruara në institucione shqiptare të akredituara të arsimit të lartë nga institucione të huaja të arsimit të lartë
4. Vlerësimin e sistemeve të brendshme të cilësisë në IAL-të; përgatitja dhe miratimi i udhëzuesit për Ngritjen dhe funksionimin e NJSBSC në IAL
5. Mbështetja e veprimtarisë së Bordit të Akreditimit;
6. Bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse për arsimin për përgatitjen e standardeve shtetërore të cilësisë dhe përditësimin në vijim të tyre si pjesë e Kodit të Cilësisë.
7. Aktivitete në Bashkepunim me sektorë të tjerë

Në këtë kuadër ASCAL parashikon të përfundojë të gjitha procedurat që janë në proces/që vazhdojnë nga viti 2017, apo aplikimet e reja që vijnë në fillim të 2018, në përputhje me Manualin e ri të miratuar në vitin 2017. Në këtë drejtim për vitin 2018 parashikohet të:

- Regjistrohen aplikimet për akreditim në përputhje me procedurën e akreditimit për vitin akademik 2017 - 2018
- Përfundojnë procedurat e akreditimit për 4 programe dy vjecare jo universitare të ciklit të parë, që janë aktualisht në proces akreditimi nga viti 2017
- Përfundojnë procedurat e akreditimit për 15 programe të ciklit të dytë, në proces akreditimi nga viti 2017
- Përfundojnë procedurat e akreditimit për 3 IAL (2 publike dhe 1 private) në proces akreditimi institucional.
- Përfundojnë procedurat e akreditimit për 2 programe dy vjecare jo universitare
- Përfundojnë procedurat e akreditimit për 2 programe të ciklit të parë,
- Përfundojnë procedurat e akreditimit për 15 programe të ciklit të dytë,

*c. Asistencë teknike për BA dhe ekspertët e vlerësimit.*

Në planin e veprimtarive në kuadrin e akreditimit, ASCAL do të ofrojë asistencë teknike dhe financiare për Bordin e Akreditimit dhe ekspertët e vlerësimit të jashtëm. Në këtë kuadër, në përputhje me procedurën e akreditimit 2017, ASCAL do të ofrojë të gjithë materialet e nevojshme (DPA – Dosjet e plota të akreditimit) në funksion të anëtarëve të BA dhe ekspertëve. Në lidhje me përditësimin e regjistrimit të ekspertëve, fillim të vitit 2016, do të bëhet shpallja e njoftimit për aplikim për ekspertë vendas dhe të huaj. I njëjti njoftim publik që është në faqen zyrtare të ASCAL, do tju dërgohet edhe rrjeteve europiane ku ASCAL/ASCAL është partnere.



- a. Bashkëpunimin me institucionet e arsimit të lartë në kuadër të reformës dhe implementimit të ligjit të ri të arsimit të lartë me fokus të veçantë riorganizimin e njësive të brendshme të sigurimit të cilësisë në përputhje me këtë ligj.
- b. Një nga synimet kryesore për vitin 2018, do të jetë rikostruksioni tërësor i ambienteve të ASCAL/BA. Agjencia ka kërkuar mbështetjen finaciare për realizimin e këtij synimi.
- c. Në kuadrin e përmirësimit të funksionimit dhe procedurave, ASCAL do të vazhdojë marrjen e mendimeve nga ekspertët e huaj të vlerësimit të jashtëm me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të procedurave me të cilat ASCAL do të funksionojë.
- d. Synohet pjesmarrja në të të gjithë aktivitetet dhe eventet e organizuara nga partnerët dhe bashkëpuntorët tanë. ASCAL do të synojë financimin me fonde, kryesisht nga projektet e Komisionit Europian, të ndryshme me qëllim ngritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e treguesve të performancës pas riorganizimit dhe ristrukturimit të saj, si kundër janë Twinning, Taiex, Erasmus + etj.